

BIBLIOTEKA
SHTETIT

89H-94

SH 99



I. NELAJ B. ÇELIKU

MYSLYM SHYRI

SJH-P4

56.99

ISUF NELAJ — BEDRI ÇELIKU

MYSLYM SHYRI




35680

SHTEPIA BOTUESE «8 NENTORI»

121. NERVI — BESËDI GJITHË

MUSLIM SHYRI



Tirazhi 5000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1978



Heroi Popullit MYSLYM SHYRI

FĒMIJĒRIA

Barrë e rëndë mbi shpatullat e njoma

Ende pa zbardhur drita, kur me zor dalloheshin konturet e Dajtit, që siç dukej dhe ai dilte me vësh-tirësi nga nata e errët e asaj kohe plot dhimbje, nga pesha e vuajtjeve të ditës, ngrihej ngadalë dhe hapte me kujdes derën e madhe të dhomës që të mos kërciste e të zgjoheshin dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Shtëpia e vogël përdhese, me qerpiç, pa korridor dhe derën që të nxirrte direkt në rrugën afér Varrit të Bamit, sikur e ndiqte pas me atë të kolliturën e babait, me rënkimin e fëmijëve të vegjël që u dhimbnin brinjët ngaqë flinin përdhe në rrugozë, e ndiqte me krismën e derës. Ekte me të shpejtë për në dyqanin e ustait ku e prisnin shumë punë, që duhet t'i bënte si çirak; pavarësisht se ishte vetëm njëmbëdhjetë vjeç, pesha e rëndë e hallevë çdo ditë e më shumë rëndonte mbi shpatullat e tij të njoma, ashtu siç rëndonte dhe mbi fëmijët e tjerë në ato vite të regjimit antipopullor të Zogut.

Ky djalosh i vogël me trup mesatar, me flokë të zez, me fytyrë të rrumbullakët, me sy të mprehtë, i shkathët dhe energjik, i pamposhtur ndaj vuajtje-

ve ishte Myslym Shyri, (Lymi siç e thërrisin në familje, siç e thërrisin shokët e tij). Ai shpejt ishte ndarë nga lodrat e fëmijërisë, nga shokët e mbi të gjitha nga shkolla që e dëshëronte aq shumë; shpejt ai kishte filluar të kuptione hallet që kishin rënë mbi prindërit e tij, gjendjen e familjes, ndaj kërkoi të hynte në punë e të nxirrte vetë bukën e tij. Babai i tij, Saliu, ishte i vafër, me vështirësi siguronte dhe bukën e gojës në punë të ndryshme si punëtor sezonal. Verës në një qoshe të pazarit shtronte rrogozin ku hidhte dy-tri shporta pemë dhe shiste gjithë ditën. Qëllonte që humbte më shumë sesa fitonte dhe atëherë kuptohej. Familja e tij e përbërë prej gjashtë vetash, nënës, Lymit dhe katër fëmijëve të vegjël, jetonte shumë keq në shtëpinë përdhese me qerpiç, plot lagështirë, pa krevatë, me rrugozë. Asaj shpesh i mungonte jo vetëm vajguri por dhe buka. Nëna e Lymit, Metija, rënkonte nga reumatizma, vuajtjet kishin gërryer jetën e saj dhe shumë shpejt ë la jetim Lymin, dy motrat e vëllanë e tij. Lymi ishte dy vjeç. Pas ca kohësh u bë me njerkë. Ajo e gjeti Lymin të vogël, sapo ishte djegur me ujë të valuar në bark dhe rënkonte nga dhimbjet. Njerka u kujdes për të tamam sikur të ishte fëmija e saj. E mjekonte vazhdimi shsipas këshillave të një mjeku popullor. Vuajti shumë derisa u shërua, por në pjesën e barkut i mbeti një njollë sa një shuplakë dore. Rritej Lymi në mes të haleve dhe vështirësive, rritej si bima në shkëmb që dhe pse është e dobët ka rrënjen e trup të fortë.

Zbardhjen e ditës e priste me shqetësim. Shpesh i dilte gjumi nga èndrrat që shihte: i dukej sikur kishte rënë dielli dhe ai ishte vonuar për në punë. Vraponte me të shpejtë për në dyqanin e ustait ku e

priste pastrimi i lokalit, mbajtja e qomyrit e druve, punët e pazarit dhe shumë punë të tjera të rënda, që çdo ditë e më shumë peshonin mbi shpatullat e tij të njoma. Tërë kjo lodhje bëhej vetëm për të siguruar kafshatën e bukës se për rrobet nuk diskutohej. Nga rröpatjet tërë ditën ato griseshin dhe njerka e tij, që i thërriste nënë, vonë natën i arnonte me dhimbje në zemër për djalin që punonte dhe s'kishte një rrobe të re që të gëzohej.

Po e tillë ishte gjendja. Ishte viti 1927. Regjimi antipopullor i Zogut interesohet vetëm për xhepat e tij, që i mbushte me djersën e popullit. Fati i Lymit dhe i shokëve të tij ishte fati i qindra e mijëra fëmijëve që endeshin rrugëve, që s'kishin kushte për të vazhduar shkollën, që shtypeshin nga të pasurit e që vdisnin nga varfëria e nga sëmundjet. Po kishte fëmijë që pispilloshin e që i shikonin me përbuzje të varfërit. Këta ishin fëmijët e pasanikëve që Lymi i urrente shumë.

Çdo ditë herët çante erën e ftohtë të mëngjesit, e fytyra i bëhej flakë e kuqe, për të vajtur në dyqanin e ustait dhe në mbrëmje vonë kthehej ngadalë i lodhur për në shtëpi. Megjithëse ishte i vogël në moshë, kishte dëshirë t'u conte diçka në shtëpi prindërve, motrave, vëllait që ishte pa punë, t'u conte nga simitet e qoftet që kishte ustai në dyqan, por ishte e pamundur. Kush e linte të mirrte në dyqan?

Ustai i tij e shikonte me përcnim, e fyente. E fyenin dhe fëmijët e tij. Një urejtje i mblidhej si lëmsh në grykë; donte të dilte jashtë dhe një ditë shpërtheu me një të pështyrë në pragun e dyqanit, për të mos shkelur më kurrë aty.

Po ku do të shkonte? Ku do të punonte? Ç'do të

thoshte babai? Këto shqetësime e mundonin, por... më mirë në rrugë sesa i nënshtruar.

Përsëri djaloshi me rroba të arnuara endet për të nxjerrë ndonjë lek, endet bashkë me Ferit Xhaj-kun e të tjerë. Çfarëdolloj pune pranojnë, edhe atë më të rendën. Dhe ja një punë e përkohshme. Morën vesh se afër lëmit, kù ndërtohesh një rrugë, dheu dhe zhavorri transportoheshin me vagona që shtyhesin me krahë. Dhe Lymi filloi të punonte aty. Por a ishte kjo punë për fëmijë? Që ditën e pârë vagoni i zuri gishtin e dorës së majtë të cilin ia preu fare. E mjekuan shokët e punës dhe e dërguan në shtëpi. Megjithëse i vogël e duronte dhimbjen, s'e jepte veten. Dora i mbeti me katër gish-térinj. Ai përsëri dilte në rrugë të kërkonte ndonjë punë të rastit; qëllonte që s'kthehej në shtëpi fare, flinte herë te Feriti e herë te Hamdiu. Qëllonte që vinte vonë në shtëpi; vetëm njerka e shihte dhe ai ia bënte më gisht që të mos i tregonte të atit. Të nesërmen në mëngjes hapte derën me kujdes që të mos kërciste dhe dilte për të kërkuar ndonjë punë.

— Djali pò merr rrugë të keqe, — thoshte i ati.

— Po ç'të bëjë, nga halli, kërkón ndonjë punë, — i përgjigjej e shoqa.

— Po érdhi, i thuaj të mos ikë se ia kam gjetë punën, por duhet të rrijë urtë dhe të mos më tur-përojë se atij ustait s'kam fytyrë t'i dal përpara.

Dhe nisi përsërijeta e hyzmeqarit, tanë në një furrë buke. Atje punonte dhe vëllai i tij Ramazani¹⁾ që ishte më i madh.

1) Ramazan Shyri, ishte partizan i Çetës së Pezës, pastaj kaloi në Brigadën XXII S. Vdiq në vitin 1965.

... Edhe ai që i vogël ishte i detyruar të hynte në punë, të provonte shtypjen e të pasurve, fyjet dhe përbuzjet e tyre. Megjithëse 3 antarë të familjes punonin, gjendja ishte mjaft e varfër. Të ardhurat kurrë nuk kishin stabilitet dhejeta përkundej në pasiguri, varfëri, vuajtje dhe ëndrra për t'i dhënë fund mjerimit.

Vdekje të parakohshme

Atje ku ka vuajtje e mjerim, ka dhe sëmundje e vdekje të parakohshme.

Bejtja, motra e tij për nënë e babë ishte anemike, e dobët. Vuajtjet për ushqim, fjetja e keqe, lagështia kishin ndikuar mbi trupin shëndetlig të saj. Dimri i vitit 1929 ishte i ashpër. Motra vuante nga ethet. Trupi i digjej nga temperatura. Mjeku e ilaçet mungonin. Një ditë Saliu, më në fund, kishte gjetur një mjek që i kishte premtuar se do të vinte të nesërmen në mëngjes, mbasi kishte dhe shumë të sëmurë të tjerë.

Rënkitmet e të sëmurës natën prishnin gjumin e të gjithëve dhe të Lymit e të Ramazanit, që lodheshin nga puna e rëndë dhe binin të kapitur. Prisnin me padurim të nesërmen që të vinte mjeku. Nuk dihej se në ç'orë rënkitmet kishin pushuar dhe të gjithë i kishte kapur një gjumë i rëndë. Flinte dhe Bejtja, por ajo po bënte gjumin e përjetshëm. Ai trup që digjej zjarr ishte ftohur, ishte zbardhur si muret e shtëpisë.

— Doktori! a, doktori! — thirri me inat Saliu; ndërsa të tjerët qanin. Mëngjesi i asaj dite të zymtë erdhi me një shi të ftohtë.

Lymi ndiente një dhimbje të madhe për humbjen e motrës. Fëmijët i nxorën nga shtëpia që kishte vetëm një dhomë dhe i çuan te shtëpia e komshiut. Lymit nuk i rrihej brenda, por dilte jashtë nën strehët e shtëpisë, që kullonin nga shiu. Vështronnte nga Dajti, që e kishte mbështjellë kësulën e bardhë të tij me retë e dendura të zeza, të zeza, si shamitë e grave që hynin e dilnin në shtëpinë e tij.

Por pranë Lymit vijnë shokët e tij Hamit Shijaku, Ferit Xhajku, Hamdi Mézezi etj. që e bëjnë të mposhtë dhimbjen. Ndërprerja e punës si hyzmeqar, qoftë dhe një ditë, kishte pasoja për jetesën. Ndaj ai përsëri bashkë me vëllanë çdo mëngjes drejtohet për në furrën e bukës.

Gjendja e familjes vjen duke u vështirësuar. I ati, Saliu, kur ndodhej keq bluante mendimet me veten e tij për të dalë nga hallet. Përpara dhjetë vjetëve ai kishte shitur shtëpinë që ia kishin lënë trashëgim prindërit. Ishte një shtëpi e vogël më dhomë, kuzhinë, oborr. E kishte shitur nga halli dhe kishte zënë këtë shtëpi që përbëhej vetëm prej një dhome, (ajo ishte dhomë fjetje, ajo kuzhinë). Tetë frymë jetonin në atë dhomë të vogël përdhese. Tetë frymë kalonin natën e ftohtë në rrugën Qemal Stafa, ndienin dhimbjen e brinjëve, rrotulloheshin nga një krah në krahun tjetër.

Por qiraja ishte e madhe për këtë shtëpi, gjithashtu ishte shumë larg qendrës së qytetit. Saliu gjeti një shtëpi tjetër (sot në rrugën Qemal Stafa), por dhe kjo kishte vetëm një dhomë, ishte me qerpiç dhe me lagështi.

Lymi tani ishte më i rritur dhe e kuptonte më mirë jetën. Nuk e duronte shtypjen e të pasurve,

pagën e paktë. Shpesh ai s'kthehej në shtëpi, flinte nëpër shokë.

I ati shqetësohej. E pyeste se ku shkonte, kishte frikë se mos kishte marrë rrugë të keqe.

— S'kemi shtëpi, jemi ngushtë, por ja po rriteni ju, do të fitojmë dhe më vonë do të kemi dhe ne një shtëpi për të jetuar si njerëz, — i tha një ditë i ati.

— Po me kaq sa marrim, ne kurrë s'kemi për ta arritur atë, — iu përgjigj Lymi.

— Nuk dihet si ecën pazari, këtë verë mund të fitoj me pemët, s'dihet bir mos i humb shpresat.

Shpresonte i ati por më kot. Megjithëse s'i kishte mbushur 55 vjetët ai dukej shumë më i moshuar. Vuajtjet dhe sëmundjet e kishin dobësuar dhe plakur para kohe. Puna me shitjen e pemëve ishte me sezone e pa kurrfarë sigurie; kishte muaj të tërë që mbetej pa punë. Kaloi koha dhe përsëri erdhi një dimër i ashpër, një fatkeqësi tjetër për Lymin. Ishte dimri i vitit 1935, i egër, i ashpër, si gjithëjeta në atë kohë të shtypjes dhe të shfrytëzimit. I ati nuk mund të ngrihej nga shtrati. Kolla e rendë, që dëgjohej gjer në rrugë, e mundonte shumë. Një ditë kur u kthye në darkë nga puna gjeti shumë njerëz në shtëpi, zëra, të qara. Iu prenë gjunjët, e kuptoi. I ati i kishte vdekur. Ai la shtatë frymë. Tani Lymi kishte një vëlla dhe një motër për babë e nënë, dy motra e një vëlla për babë dhe njerkën, që kërkonin të ushqeheshin e të visheshin, shtëpia kishte qira të madhe. Pesha e shtëpisë ra e gjitha mbi kurrizin e Lymit dhe të Ramazanit. Puna që bënin në furrë ishte vetëm sa për të siguruar bukën e tyre, po për pjesëtarët e tjerë të familjes? Lymi mori shportat e babait dhe zuri qoshen e pazarit

për të shitur pemë. Hamiti që kishte braktisur shkollën kishte mbetur pa punë, Lymi i propozoi që të shisnin pemë bashkë. Kështu ata vazhduan shitjen e pemëve, por vetëm ditën e pazarit; ditë të tjera nuk kishte klientë kështuqë dilnin të kërkonin punë.

Në turmën e të papunëve

Regjimi i Zogut e kishte lënë popullin në prapambetje të madhe, ai vetëm e grabiste për të mbushur arkat e tij. Papunësia e shfrytëzimi kishin plakosur kudo në çdo qytet e fshat të vendit. Në Tiranë, përveç të papunëve të qytetit, zbrisnin dhe fshatarë nga të gjitha anët e vendit, për të kërkuar punë.

Në të dalë të Pazarit të Vjetër, përballë sahatit, në trotuarin plot gurë, çdo ditë ndesheshe përpara një turme burrash, të rinjsh e fëmijësh të veshur keq, të lodhur e të kapitur ngajeta, hallet dhe pasiguria. Ankthi për të siguruar një kothere bukë për atë ditë i mundonte tmerrësish. Qëndronin me bela, lopata, sharra e sopata në duar. Prisnin të vinte t'i merrte ndonjë pasanik që kishte nevojë për punë. Dhe ja një ditë dikush mori disa djem, në mes tyre dhe Lymin, për të hapur një kanal të ujërave të zeza. Punoi atje dy ditë pastaj përsëri mbeti pa punë. Kohë më pas një tjetër i mori për të punuar në një fidanishte në Laprakë. Lymi u mësua dhe më punë të bujqësisë, shkulte, mbilltë fidanë, hapte gropë, prashiste. Ai bënte qfarëdolloj pune. Lodhej e rropatej tërë ditën për të fituar bukën e gojës, por një pjesë të kohës dhe natën filloj t'ia kushtonte aktivitetit revolucionar.

Shpërblimi që merrte nga pronarët ishte shumë

i vogël. Kishte ndonjë shok të tij që me të marrë rrrogën vraponte në ndonjë bufe të pinte ose të hante diçka, kurse Lymi, porsa i merrte, i shikonte, pastaj i shtrëngonte në dorë, vinte dy grushtet në kokë dhe me një ton therës bërtiste:

— Ah gjakpirës!

Kjo ishte një thirrje proteste e brendshme, që shpërthente ndaj padrejtësive të kohës. Ishte një shprehje pakënaqësie e zemërimi ndaj pronarëve që shfrytëzonin pa mëshirë.

Një ditë njeri nga shokët i tha Lymit:

Disa kohë më parë një komunist më ka shpjetuar se ç'është mbivlera. Të them të drejtën në fillim se kuptova. Ai e vuri re këtë dhe ma shpjegoi me fjalë shumë të thjeshta. Ja si më tha: «Punëtorët punojnë; lodhen për pronarët, kapitalistët, ata kryejnë punë por nuk paguhen për vlerën e punës që bëjnë, paguhen pak, pjesa tjetër shkon në favor të kapitalistëve, kjo është mbivlera. Sa më e madhe — të jetë kjo aq më shumë fryhen kapitalistët dhe shtrydhën punëtorët, prandaj duhet të ngrihem i kundër kapitalistëve».

Ndjenja e urrejtjes për të pasurit i rritej, donte të shpërthente, por se si nuk e kishte të qartë. Bashkë me shokët e tij e gjeje përsëri çdo mëngjes në kalldremet e pazarit, në ushtrinë e të papunëve.

FILLIMI I AKTIVITETIT REVOLUCIONAR

Urrejtje për fashizmin dhe regjimin e Zogut

Shokët më të ngushtë të Lymit ishin Hamit Shijaku, Hamdi Mëzezi, Ferit Xhajku. Këta shokë, të rritur bashkë që në fëmijëri, i afronte idealit përbashkët. Në dejet e tyre lëvrinte dashuria për atdhenë, që ëndërronin ta shikonin të lirë, urrejtja për regjimin e Zogut, për bejlerët, tregtarët dhe sahanlëpirësit e tyre.

Por Lymi shquhej për karakterin e tij të fortë, ishte i shkathët, i pjekur, pak nevrik, revolttohej shumë shpejt, s'duronte padrejtësi.

Një ditë në mëngjes, tek po prisnin në turmën e të papunëve erdhën dy djelmosha të rinj: ishin Asim Vokshi dhe Teni Konomi. Lymi dëgjonte me vëmendje Asimin dhe i bënte përshtypje gjallëria, mprehtësia dhe qartësia me të cilën fliste. Lymi tani filloi të merrte vesh diçka përfashizmin, i cili kërçenonte edhe pushtimin e vendit tonë. Ai mori vesh se Italia fashiste kishte sjellë flotën ushtarake në ujërat detare të Durrësit, kishte zgjatur çizmen e saj përfshikelur në Shqipëri, mësoi dhe shumë gjëra të tjera që ai nuk i dinte ose i kishte të pa-

qarta. Kështu dalngadalë horizonti i njohurive të tij zgjerohet. Në këtë drejtim ndikojnë edhe shokët e tij të afërt. Hamiti kishte mbaruar vetëm shkollën fillore por ishte i dhënë shumë pas leximit, sidomos të literaturës përparimtare. Ai kishte grumbulluar mjaft libra dhe kishte krijuar një bibliotekë në shtëpi. Midis librave të tjera ai i dha Lymit literaturë përparimtare që kishte filluar të përhapej nga komunistët. Lymi i lexonte me ëndje të madhe.

Një ditë Hamiti i dha një broshurë të përgatitur nga komunistët. Në atë broshurë demaskohej regjimi gjakatar i Zogut. Lymi e lexonte dhe i rritej urrejtja për këtë regjim, i rritej urrejtja për të pasurit, shtypjen e të cilëve e ndiente çdo ditë si shumë të tjerë mbi shpatullat e tij.

Në vitin 1936, revista «Bota e re» që kishte filluar të dilte, nëpërmjet Hamitit, binte vazhdimisht në duart e Lymit. *Ndonëse në shkrimet e botuara përdorej, për shkak të censurës, gjuha e Ezopit, «Bota e re» u bë në duart e komunistëve një armë e fuqishme e kritikës kundër regjimit në fuqi dhe plagëve të shoqërisë shqiptare. Ajo zhvilloi një luftë të ashpër kundër ideologjisë reaksionare fashiste dhe trajtoi në frymën demokratike revolucionare problemet themelore shoqërore e politike që qëndronin përpara popullit duke ftuar opinionin demokratik shqiptar të luftonte për zgjidhjen e tyre».¹⁾*

Futura e materialit propagandistik në masat e rinisë ishte një detyrë e rëndësishme e komunistëve, por përveç kësaj ata i jepnin rëndësi edhe formave të tjera. Shpeshherë përdornin edhe shoqëritë kul-

1) «Historia e PPSH», 1975, faqe 38.

turore-artistike të cilat kishin filluar të formoheshin e të gjallëroheshin.

Lymen e shohim si bashkëpunëtor të Hamit Shijakut për formimin e shoqërisë sportive «Tomson» në vitin 1935, që më vonë mori emrin «Shpresë». Këto shoqëri nuk kishin për qëllim vetëm organizimin e aktiviteteve sportive por dhe bashkimin e masës së rinisë rrëth ideve revolucionare. Në këtë shoqëri bënин pjesë punëtorë, marangozë, tipografë, nxënës shkollash. Lymi kishte parë të vinin aty Vasil Shantoja, Mihal Duri etj. dhe t'u flisnin të rinjve për idetë komuniste, Ali Kelmendin, për forcat vullnetare që shkonin për të luftuar në Spanjë kundër fashizmit etj.

Me porosinë e shokëve komunistë Lymi dhe Hamiti ngritën grupin teatral «Shkëndia» në vitin 1936. Këtu bënин pjesë punëtorë, zanatçinj, nxënës. Grupi teatral përgatiti pjesën «Të burgosurit» e cila demaskonte terrorin zogist ndaj masave punonjëse. Të dy shokët morën të gjitha masat që shfaqja e parë të jepej me sukses. Kështu më 21 janar 1937 u dha shfaqja në kinema «Nacional» (sot «17 Nentori»). Shfaqja pati shumë sukses dhe bëri bujë të madhe. **Pjesëmarrja** kaq e madhe dhe veçanërisht përbajtja përparimitare e pjesës i shqetësoi autoritet qeveritare të cilët pezulluan dhënien e shfaqjes si në Tiranë dhe në qytetet e tjera.

Myslymi ushtar

Disa ditë pas shfaqjes erdhi rasti që shokët të ndaheshin. Lymi do të shkëputej nga ta, nga familja, asaj do t'i ikte një krahë pune.

U caktua në Shkodër për të kryer shërbimin ushtarak. U vesh me rrrobat e ushtarit dhe u rresh-tua para komandantëve, zabitëve të Zogut që e traj-tonin ushtarin si shërbëtorin e tyre. Ky trajtim Ly-mit i bëri përshtypje që ditën e parë. Ai tashmë e dinte mirë se çishte regjimi i Zogut, prandaj kishte një urrejtje të madhe dhe filloi t'u fliste dhe shokëve të tij:

«Është regjim shtypës, s'çan kokën për të var-fërit, kërkon të mbushë vetëm qesen e tij; prandaj të mos u përulemi, se ata do të na shtypin më tepër. Na duhet të mësojmë pushkën, të stërvitemi fort; vetëm kështu mund t'i mposhtim armiqtë, t'i dalim zot atdheut dhe nderit tonë, vetëm kështu do të fitojmë lirinë».

Shkathësia, gjallëria, zgjuarsia e tij, qëndresa në mendime ranë në sy të kapterit dhe të zabitit¹⁾ që kishte në kompani. Ata që të dy ia vunë syrin që ta bënин ordinancë (shërbëtor). Një ditë kapteri e urdhëroi Lymin të shkontë në shtëpinë e tij për një punë të vogël.

— Kushedi do të ketë harruar ndonjë material ushtarak, — mendoi Lymi dhe shkoi, por pas pak u kthye në kazermë dhe me zë të lartë i tha kapterit:

— Nuk jam shërbëtori yt që të çaj drutë e familjes tënde. Unë kam ardhur të kryej ushtrinë jo të bëhem shërbëtor.

— More, do të të kâlb në burg, — përsërishtë kapteri.

Zabiti, që e dëgjoi këtë zhurmë, u afrua.

— C'ke kapter, me ushtarin?

— Më kundërshton urdhrrin, zoti zabit.

1) Zabit — oficer.

— Çfarë urdhri?

— Të bëhem shërbëtori i tij, — ia preu Lymi.

— Pusho se për..., — filloi të fliste kapteri, por zabiti e ndërpren:

— Po a e di kapter se ky është ordinanci im. Pse e ke urdhëruar?

— Nuk e dija, — tha kapteri, — por ai është mistrec e s'ke ç'e do.

— As ordinanci yt s'bëhem, — tha prerë Lymi.

— Si flet kështu mëre surrat se për nalmadhninë të bëj që të mos shohësh diellin me sy. Në burg qenin — bërtiti zabiti.

Lymi qëndroi dhjetë ditë në burg, por ordinancë nuk pranoi të bëhej kurrë.

* * *


Pasi u kthye nga ushtria përsëri ra në kontakt me shokët e tij që merreshin me aktivitet revolucionar. U takua në kaldrëmet në të dalë të Pazarit të Vjetër karshi sahatit, ku përsëri do të gjente të grumbulluar ushtrinë e të papunëve. E gjeje pothuaj çdo ditë Lymin në këtë vend tek priste ndonjë pronar t'i binte me shpütën e dorës në gjoks e shpatullave për ta marrë në punë; e gjeje përsëri ditën e pazarit me shportën e pemëshitësit. Tani ishte rritur, fytyra i kishte marrë tipare më të burrëruara, mendimet e tij ishin më të pjekurë e më të plota.

Hamiti ndërmjet të tjera e vuri në dijeni përdicëka shumë të rëndësishme. Ishte takuar me dy shokë komunistë. Qemal Stafa bashkë me Vasil Shanton kishin krijuar lidhje me shumë të rinj. Ata i

kishin folur për lëvizjen revolucionare kundër re-gjimit të Zogut dhe fashizmit, lëvizje që duhej të zhvillohej më shumë.

Një nga qendrat e lëvizjes u bë libraria që kishte hapur Hamiti në vitin 1938 në Rrugën e Postës (sot rruga «Luigj Gurakuqi»), ku shokët revolucionarë vinin për të propaganduar e shpërndarë libra me ide përparimtare në masat e punëtorëve, të zanatçinjve dhe veçanërisht në masën e rinisë, që ishte e etur për libra të tilla. Në këtë librari pas disa ditësh, Hamiti, Myslymi, Feridi dhe Hamdiu morën kontakt me Vasil Shanton. Vasili e vlerësoi shumë punën që bënin këta shokë dhe aktivitetin që zhvillonin nëpërmjet kësaj librarie.

Ai u premtoi se do t'i furnizonte me disa veprat klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe me literaturë artistike.



Kështu që këta shokë, sipas porosisë së komunistëve, kryenin detyra duke përhapur idetë komuniste, duke rritur numrin e simpatizantëve. Këtij qëllimi i shërbente dhe libraria e Hamitit ku Lymi filloi të shkonte pothuaj çdo ditë kur kthehej nga puna. Aty u njoh dhe me shumë shokë si Reshit Rusin¹), Hajrulla Kastratin²) etj. Së bashku me Hamitin vendosën të krijojnë disa baza jo vetëm në qytet por dhe në fshat.

Një ditë vere të vitit 1938 Lymi bashkë me Hamitin shkuan në fshatin Shkozë në shtëpinë e Rremë Rasës (Spahiut). Ata nuk shkuan për t'i bërë thjesht një vizitë si mik i familjes që e kishte një shoku i tyre, po për ta kthyer shtëpinë e Rremës në një bazë që ta kishin në çdo rast që do t'u nevojitej. Pasi Lymi i foli gjatë Rremës për gjendjen e mjeruar të vendit tonë dhe për lëvizjen që kishte filluar për të përbysur këto padrejtësi, Reema tha:

— S'më besohet more Lym. Mund të rrëzohet mbreti, se shumë qeveri janë ndërruar por hallet tona kurrë s'i kanë zgjidhur.

Por pas një bisede të gjatë me të rinjtë Reema tha:

— Shtëpia ime është e hapur gjithnjë për ju, për njerëz që na i kuptojnë hallet tona e luftojnë për ne.

Me këto fjalë ai u nda me dy të rinjtë të cilët i lanë përshtypje të madhe për fjalët e ngrohta e plot bindje që e ardhmja e të varfërve do të ndryshohet. Lymi kishte filluar të hynte në zemrat e njerëzve me fjalët e tij të zjarrta, të thjeshta dhe plot ide.

Shtëpia e Rrem Rasës gjatë gjithë kohës shër-

1, 2) Dëshmorë.

beu si një bazë e rëndësishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Atje u dërguan armë, u strehuan shokë ilegalë e partizanë të Çetës së Dajtit dhe të Brigadës III S, u bënë mbledhje etj.

Shqetësim pér fatet e atdheut

Zogu kishte kohë që ndiqte politikën e dyerve të hapura ndaj fuqive kapitaliste, ndiqte një politikë profashiste. Kjo kishte shkaktuar urrejtje në masën e gjerë të popullit tonë. «Politika thellësisht reaksionare profashiste e Zogut ngjalli ndër komunistët dhe patriotët shqiptarë një shqetësim të madh pér fatet e pavarësisë së vendit»¹⁾

Më 1938 erdhë në vendin tonë ministri i financave të Italisë Theon Deroveshi, i cili i kishte dhënë një kredi prej mijëra franga ari qeverisë së Zogut.

Kryetari i bashkisë duke folur pérpara popullit ngrinte në qìell këtë «ndihmë» që Italia i dha Shqipërisë. Shumë të rinj që ishin në mes të grumbullit të njerëzve dëgjonin e kuptionin se kjo kredi ishte një mashtrim; Italia fashiste po lëshonte kthetrat e saj djallëzore pér të skllavëruar vendin.

Lymit nuk iu durua më dhe thirri:

— Ato t'i dhanë ty!... Këto fjalë shkaktuan zhurmë dhe të qeshura.

Ai s'pushoi së foluri me çdo të ri që merrte kontakt, pér të demaskuar regjin e Zogut dhe politikën e tij tradhtare.

1) «Historia e PPSH», 1975, f. 41.

* * *

Arrestimi i shokëve Qemal Stafa, Vasil Shanto, Nazmi Rushiti, Emin Duraku e i mjaft komunistëve të tjerë nga qeveria e Zogut solli një shqetësim të madh e zemërim në radhët e rinisë patriote shqiptare. Ditët që zhvillohej gjyqi, atë dimër të ftohtë të 1939-ës, Lymi me Hamdiun, Hamitin, Feritin e shokë të tjerë vinin rrëth e qark bashkisë dhe interesoheshin për të marrë vesh ndonjë gjë për ta. Iu bë zemra mal kur morën vesh qëndresën heroike të tyre e sidomos të Qemalit.

«Duhet të punojmë akoma më shumë» — thoshte shpesh.

Në krye të demonstratave

Në saje të punës agjitative të shokëve të grupave komuniste, që ishin në Tiranë, lëvizja përparrimtare kishte shtrirë krahët në çdo skaj, ajo ishte futur dhe në shkolla. Më 1 prill 1939 vajzat e shkollës normale të Tiranës dhanë një shfaqje me përbajtje përparimtare, pjesën «Për mbrojtjen e atdheut» në kinema «Gloria» (sot kinema «Republika»). Lymi bashkë me shokët para shfaqjes kishin bërë një punë të mirë për propagandimin e saj. Për të siguruar pjesëmarrjen ata nuk bashkëpunuan vetëm me punëtorët e zanatçinjtë por edhe me rininë e gjimnazit të asaj kohe. Kështu që kinemaja u mbush plot nga rinia shkollore dhe joshkollore, nga zanatçinjtë dhe punëtorët.

Kur shfaqja ishte në mbarim dhe në skenë vdes

vajza duke qëndisur flamurin e Shqipërisë, të rintjtë patriotë, midis të cilëve edhe Myslim Shyri u ngritën të parët në këmbë dhe filluan të këndojnë himnin e flamurit duke nderuar me grushtin lart. Menjëherë i pasuan edhe të tjerë dhe gjithë salla buçiti. Dolën nga kinemaja dhe morën rrugën në drejtim të sheshit. Turma sa vinte bëhej më e madhe. Shumë vetë sa dëgjonin këngën dilnin nga shtëpitë e bashkoheshin me demonstruesit. Turma rritej si një lumë nga rrjedhjet e shumta të burimeve.

Të rintjtë, ndërmjet të cilëve ishte edhe Lymi filluan demonstratën kundër fashizmit italian që po përgatiste pushtimin e Shqipërisë. Demonstruesit u drejtuau për në legatën italiane. Aty hodhën parulla kundër qëllimeve agresive të Italisë fashiste ndaj vendit tonë. Që andej u drejtuau për në të gjitha legatat e huaja që ishin asokohe në vendin tonë. Të rintjtë, midis të cilëve kishte edhe komunistë, protestonin kundër fashizmit dhe i bënин thirrje popullit për të rrëmbyer me forcë armët dhe për të prioritur me plumb ballit pushtuesin. Pastaj demonstruesit u drejtuau për në pallatin e mbretit Zog. Për tu mbrojtur nga demonstruesit në të hyrë të pallatit dolli adjutanti i Zogut me gjithë xhandarët e gardës mbretërore. Demonstruesit u zembrapsën me forcë dhe u rrëthuan. Një pjesë e tyre, ndër të cilët edhe Lymi, u arrestuan. Pas disa ditësh e liruan.

Lymi përsëri merr pjesë në demonstratat e 5-6 prillit 1939 që u organizuan nga komunistët. Në këto demonstrata merrnin pjesë punëtorë, zanatçinj, çirakë e nxënës të shkollave të teknikës e të gjimnazit. Ai bashkon zërin me shumë të tjerë duke hedhur parulla kundër Italisë fashiste, merr pjesë në aksione

kundër disa oficerëve të Zogut, të cilët pasi i rrakin rëndë u marrin pistoletat, duke i diskredituar hapur.

Ditë të vështira

Në ato ditë kur Italia fashiste po zbarkonte në Durrës Lymi është në turmën e njerëzve që protestojnë, kërkojnë armë për të luftuar fashizmin. Por populli, megjithëse i tradhtuar nga mbreti, i cili ua mbathi këmbëve duke u krijuar terrenin e përshtatshëm fashistëve për pushtim, rezistoi dhe e detyroi fashizmin të zembrapset disa herë në det. Por çizmja e armikut shkeli vendin tonë. Një hije e zezë u ndeh anekënd atdheut, por shpresat përfitore e përliri nuk u shuan. Ato ngroheshin nga idetë marksiste-leniniste, nga komunistët që i përhapnин ato.

Gjendja ekonomike si e shumë familjeve të tjera edhe e familjes së Lymit vazhdonte të vështirësohej, shpesh mungonte edhe buka. Ai bashkë me shokët e tij kërkonin punë, përsëri në turmën e të papunëve te kalldrëmet e Pazarit të Vjetër, karshi sahatit. Një javë të tërë qëndroi, asnjeri nuk u afrua. Pas një jave erdhën disa italianë. Një burrë i gjatë me krahun e përveshur e leshator filloj të provonte shpatullat e gjoksin e të rinxve. Vuri dorën mbi gjoksin e Feritit, pastaj mbi Lymin. E shikonte me neveri atë dorë fashisti t'i binte si një gur mbi shpatulla pastaj me shputën e saj t'i binte gjoksit. Në çast u revoltua dhe mendoi ta kapte fashistin dhe ta hidhte përtokë, ta shkelmonte, por u përbajt, mendoi: puna, buka. Çdo veprim, do kohën e vet...

Së bashku me Feritin i dërguan te Shkambi i Çamë, buzë Erzenit, për të nxjerrë gurë. Puna ishte shumë e lodhshme, kurse paga mjaft e ulët. Feriti i mërzitur i propozoi shokëve ta linin punën.

— Duhet të punojmë, — u thoshte Lymi, — nga ne presin familjet, shokët dhe ilegalët.

Fjala e tij peshonte dhe shokët i bindeshin.

Ata hoqën këmishat dhe filluan punën. Ishte ditë pranvere. Dielli i nxehtë kishte filluar t'i japë ngjyrë çokollatë shpatullave të tyre. Lymit i dilte në pah pjesa e djegur në bark që në fëmini.

— Është shenja e fëminisë — i thotë Feriti.

— Edhe gishti i shkurtuar, dy shenja të mira m'i la fëminia, — u përgjigj Lymi.

Pasi përfundojnë punën në nxjerrjen e gurëve, të dy shokët hyjnë në shoqërinë italiane «Marinuci» dhe pastaj në «Xhenio militare». Punojnë si punëtorë krahu duke bërë punë nga më të rëndat. Lodhja ishte e madhe, që nga mëngjesi e deri në orët e vona punonin pa pushim, por megjithatë Lymi gjente kohë për t'u marrë edhe me aktivitet revolucionar.

Pas pushtimit fashist Qemali, Vasili e disa shokë të tjerë dalin nga burgu dhe rifillojnë aktivitetin e tyre për të përhapur idetë komuniste, për të afruar e riorganizuar shokët e këtij grupi.

Lymi i kryente mirë detyrat që i ngarkoheshin, luftonte në shoqërinë «Xhenio militare» ku punonte, për të rritur te punëtorët ndjenjën antifashiste, guximin, kurajën për të kundërshtuar pushtuesit. Për këtë qëllim organizuan dhe një grevë për ngritjen e pagave.

— Duhet të kundërshtojmë, shokë, të mos u përulemi se na i vënë peshën më të rëndë në kurriz e na paguajnë më pak, — thoshte Lymi.

— Por mos bëhet më keq, na përzënë nga puna, — tha një ditë një punëtor.

— Jo, shokë, duhet t'u tregojmë atyre se nuk jemi kafshë që të na fusin nën zgjedhë kur të duan. Duhet të na kenë frikë fashistët. Dhe greva shpërtheu. Sipërmarrësit me premtimë boshe u munduan të bindnin punëtorët dhe arritën t'i shpérndajnë.

Lymi ishte ndër ata që ra në sy për organizimin e grevës. Shoqëria italiane e përzuri nga puna. Ndërsa po priste si zakonisht te vendi i të papunëve, i afrohet një shok komunist dhe i propozon që të hapnin një barakë të vogël te Pazari i Ri për të shitur fruta e zarzavate. Ai i tha se do ta prezantonte me Rexhë Deliun, një patriot dhe kundërshtar i regjimit të Zogut. Pas disa ditësh Lymi u njoh me të. Rexha i dukej burrë i pjekur e besnik. Ai vinte herë pas here e u sillte zarzavate për t'i shitur dhe me këtë pretekst filloi lidhja e tij nëpërmjet kësaj barake me shokët komunistë.

Kjo barakë dhe pas formimit të Partisë shërbeu si pikë takimi midis shokëve ilegalë; nëpërmjet saj bëhej e mundur në disa raste dhe shpérndarja e trakteve dhe e materialeve të Partisë.

Ardhja e shokut Enver Hoxha në Tiranë i dha një hov të madh lëvizjes revolucionare e komuniste.

Duke e çmuar vendosmërinë e anëtarëve të thjeshtë të grupeve komuniste për të luftuar kundër

fashizmit dhe dëshirën e tyre të zjarrtë për bashkimin e lëvizjes komuniste dhe themelimin e Partisë, Enver Hoxha zhvilloi ndër ta me durim e urtësi një punë të palodhur sqaruese dhe organizuese. Ai vendosi njëkohësisht lidhje me nacionalistë patriotë që e urrenin pushtuesin fashist dhe ishin të gatshëm të luftonin kundër tij.¹⁾

Shokët komunistë ashtu dhe Lymi ishin më të qartë përrugën që kishin nisur, kishin më të qartë perspektivën, ishin më të vetëdijshëm për aktivitetin që zhvillonin. Ai mori pjesë në demonstratën e madhe më 28 tetor 1941 ditën kur fashistët kremtonin përvjetorin më të shënuar të ardhjes së tyre në fuqi, që e kishin quajtur «Marshimi mbi Romë». Në këtë demonstratë «morën pjesë masa të gjera popullore të kryeqytetit. Organizatori i kësaj demonstratë ishte Enver Hoxha».²⁾

Për përgatitjen e demonstratës ishin marrë masa, ishin angazhuar me detyra në radhë të parë komunistët. Kjo demonstratë, siç thuhet në Historinë e Partisë, «ishte guri i provës për bashkimin e komunistëve shqiptarë»^{3).}

Ishte ora 9 e mëngjesit. Autoritetet fashiste kishin organizuar një mbledhje solemne në kinema «Rex» (sot «17 Nëntori»). Nxënësit e shkollave të cilët merrnin pjesë në atë mbledhje ishin porositur që të hidhnin parulla e të këndonin këngë patriotike, për të sabotuar me çdo kusht ceremoninë. Rreth

1) «Historia e PPSH», 1975, faqe 60.

2) Po aty, faqe 69.

3) Po aty.

sallës nëpër dyer qëndronin të grumbulluar komunistë, punëtorë, zanatçinj, nxënës.

Porsa filloi të fliste gjerarku fashist, në sallë kumboi parulla «Poshtë fashizmi!», «Rroftë Shqipëria! Pastaj kënga e fuqishme «O djem rrëmbeni pushkët!» pushtoi gjithë sallën. Thirrjet dhe këngët gjëmonin dhe jashtë nga shokët që ishin mbledhur për demonstratë. Forca të shumta të karabinierisë vërvshuan brenda dhe filluan të nxjerrin nxënësit jashtë. Nxënësit dilnin nga salla e kinemasë dhe bashkoheshin me demonstruesit që ishin mbledhur. Me flamurin kombëtar në krye masa e demonstruesve u derdh rrugëve të kryeqytetit. Komunistët, ndër ta dhe Lymi, ishin të parët që hidhnin parulla dhe këndonin «Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë. . .» «Eja mblidhuni këtu!» Radhët e demonstruesve shtoheshin vazhdimisht. Qytetarët dëgjonin parullat kundër fashizmit, këngët patriotike e revolucionare, shihnin flamurin kombëtar e zemra e tyre ndizej, rritej ndjenja kombëtare, dashuria për lirinë, rritej urrejtja për armikun. Shumë shtëpijakë lanë shtëpitë, zejtarët myllën dyqanet dhe u bashkuan me masën e demonstruesve.

Kaluan rrugën që sot mban emrin Rruga e Barrikadave dhe rrugën «28 Nëntori», nga Sheshi Skënderbej në Rrugën e Kavajës (sot «Konferenca e Pezës») duke thirrur kundër fashizmit, duke kënduar këngë patriotike. Kudo që kalonin numri i tyre rritjej. Pastaj u kthyen përsëri në Sheshin Skënderbej. Fashistët u egërsuan shumë. Forcat e karabinierisë e të policisë u sulën për të shpërndarë demonstruesit, por ata godisnin karabinierët me parulla, me grushte, me copa tulle, me gurë, me copëra dérrase apo ç'gjenin.

... Në qendër të kësaj përleshje ndodhej vëtë organizatori dhe udhëheqësi i demonstratës, Enver Hoxha. Ai nuk jepte vetëm udhëzime e këshilla, por merrte pjesë drejtpërdrejt në betejë. Në një çast kur një nënkolonel italian iu vërsul një demonstruesi, duart e fugishme të Enver Hoxhës e mbërthyen oficerin fashist dhe e shtrinë përtokë. U turrën për të shpëtuar nënkolonelin dhe për të arrestuar njeriun që e vuri poshtë, grupe ushtarakësh armiq. Por ata u ndeshën përpara një barrikade të vërtetë trupash të rinjsh nxënës e punëtorë. Nisi përleshja. U plagosën shumë vetë nga të dy anët. Forcat e shumta të karabinierisë dhe të policisë ia arritën të veçojnë dhe të arrestojnë katër pjesëtarë të demonstratës, por demonstratën nuk e shpërndanë dot, as shokun Enver Hoxha s'mundën ta kapnin.¹⁾

Demonstruesit vazhduan demonstratën. Arrestimi i katër shokëve i revoltoi shumë. Kaluan nga Rruga e Elbasanit te zyrat e Mëkëmbësisë ku hodhën parulla e protestuan kundër fashizmit, pastaj vazhduan rrugën e u kthyen përsëri në Sheshin Skënderbej duke kaluar nga kryeministria për të kërkuar lirimin e shokëve të arrestuar. Por fashistët grumbulluan forca të shumta. Qendra e qytetit u mbush me karabinierë e policë. Ata e shpërndanë demonstratën, por në zemrën e gjithë popullit, në zemrën e Lymit rrihte më shumë dashuria për atdheun e lirë, mbushej më shumë me urrejtje për armiqtë. Vetja Lymit i dukej më e fortë dhe më e aftë përtu' ndeshur me armiqtë që kishin pushtuar vendin.

1) «Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare të popullit shqiptar», Tiranë 1975, faqe 151.

Kurrë nuk e kishte ndier veten kaq të vendosur në radhë të bashkuara me shokët komunistë, me të rinjtë, me masën e gjerë të popullit që e urrente armikun.

RRUGA E RE

Anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë

Për Myslym Shyrin po hapeshin shtigje të reja, detyra të njëpasnjëshme, detyra me përgjegjësi që mund t'i ngarkoheshin vetëm një njeriu shumë të besuar.

Që para disa ditësh ishte menduar për sigurimin e mbledhjes së përfaqësuesve të grupeve komuniste që do të formonin Partinë. Në këtë rast një masë e rëndësishme ishte edhe izolimi i njërit prej shërbëtorëve besnikë të fashizmit, spiunit të rrezikshëm Figri Çelës, i cili ishte kapiten i kuesturës fa-shiste.

Gjatë gjithë atyre ditëve dhe netëve Lymi e ndiqte këmba-këmbës spiunin, shikonte ku hynte, përgjonte sa dilte, me një fjalë ndiqte gjithë lëvizjet e tij. Në rast se do të vërente që ai do t'i afrohej vendit ku zhvillohej mbledhja do të merrte masa për t'i prerë rrugën dhe për ta vrarë. Lymi e kreua këtë detyrë plotësisht.

Diku tek ishte kinema «Nacional» (sot «17 Nëntori») Qemali mblodhi shokët e tij dhe i përgëzoi për kryerjen me sukses të detyrës. Midis tyre për-

gëzoi edhe Lymin dhe u dha shokëve lajmin e gëzuar të formimit të PKSH. Ai u lexoi Traktin dhe Thirrjen e parë të saj.

«*Ne tash e tutje jemi komunistë të vërtetë, anëtarë të Partisë sonë Komuniste! Një provë e mirë e fortë besnikërie ishte kjo që dhatë gjatë këtyre ditëve e netëve, — u tha Qemali»¹⁾.*

Lymi e ndjeu veten të gëzuar, më të fortë se kurrë, rrugët iu dukën se u ndritën. E dinte se tani e ardhmja, lumturia e popullit, fitorja e të varfërve do të ishte e sigurtë. I emocionuar, iu përgjigj Qemalit:

«*Unë i jap fjalën Partisë se jam gati të bëj çdo sakrificë, të jap dhe jetën po ta lypë nevojë. Kjo që bëra, flas për veten time si Lym, s'ishte asgjë»²⁾.*

Formimi i Partisë si për tërë komunistët qe ngjarje e madhe edhe për Lymin. Ajo ndikoi në formimin, qartësimin më të plotë ideologjik e politik të tij. Tani ai e dinte se përsë luftonte. Programi i Partisë i shprehur në traktin e parë, në thirrjen drejtuar popullit ishte ndriçim i asaj rruge që në përmjet luftës të çonte në fitore. Veprimtaria revolucionare e tij u thellua më tej.

Atij iu krijuan mundësi për një aktivitet më të madh revolucionar, se tani e kishte të qartë, si çdo komunist rrugën që duhej të ndiqte. Lymin e gjeje gjithmonë në lëvizje. Së bashku me shokët organizonin grupet edukative, drejtonin mbledhjet ilegale etj. Shpejt fitoi zemrën e punëtorëve dhe të të rinjve në qytet, në fshat e kudo që kalonte me sjelljen e

1) S. F. Andoni. «Ne do bëjmë sëç thotë Partia», Revista «10 korriku», 1974, Nr. 7.

2) Po aty.

tij shembullore prej komunisti, me fjalën e ngrohtë
dhe vendosmérinë pér të filluar luftën e organizuar
kundër pushtuesve dhe tradhtarëve të vendit.

Myslym Shyri nuk u pajtua kurrë me elementët
e lëkundur, luftonte me ashpersinë më të madhe
pér demaskimin e elementëve oportunistë e përçarës
të radhëve të Partisë dhe ishte shumë i rreptë karshi
kapitullantëve dhe armiqve. Ai vazhdimisht thoshte:
«E vetmja parti komuniste, jemi ne — Partia Ko-
muniste që lindi më 8 Nëntor 1941».¹)

Në një demonstratë pas përlleshjes me karabi-
nierët, turma e armiqve izoloi grumbullin ku valë-
vitej krenar flamuri i kuq, simbol i fitores mbi fa-
shizmin, i gjakut të derdhur e që do të derdhej
lumë pér fitoren e lirisë. Por Lymi me Ferit Xhajku-
nuk e lëshuan atë nga duart; pastaj pasi e fshehën
në gji, me ndihmën dhe forcën e shokëve, çanë rre-
thimin dhe e shpëtuan flamurin pa e lënë të binte
në duart e karabinierëve²).

Armiku u tërbua, rrjetin e spiunazhit e shtriu
kudo pér të futur në dorë komunistët, por ata ishin
në zemër të popullit e mbroheshin prej tij.

Humbje e madhe

Shoku i tij Hamit Shijaku në shkurt 1942 duke
udhëtuar nga Tirana pér në Valias, ku kishte ndër
mend të lidhej me disa simpatizantë të lëvizjes, në-
pér një rrugë që kalonte pranë një zone ushtarake,

1) «Yje të pashtuar». Vëllimi II, faqe 253.

2) Po aty.

u gjend i rrrethuar dhe u kap nga ushtarët fashistë. Pas dy ditësh e nxorën para gjyqit ushtarak fashist, që e cilësoi si komunist tepër të rezikshëm dhe e dënoi me vdekje në litar.

Lymi mori vesh për ekzekutimin e tij më 2 mars 1942.

— U vra Hamiti, por u vra si burrë duke thirrur: «Rroftë Partia! — Vdekje fashizmit!» Vdiq në litar me Internacionalen në gojë, — i tha një shok i tij Lymit.

— Trima të tillë nuk vdesin, — u përgjigj Lymi.

Ato ditë të rintjtë, në mes të të cilëve dhe Lymi bisedonin gjatë, urrejtja ndaj armikut u ziente përbrenda për të shpërthyer në hakmarrje.

— Hakun do t'ia marrim, — tha Feriti.

— Do t'ia marrim, — u përgjigj energjikisht Lymi.

Nga baraka ku shet pemë Lymi shpérndahen dhe trakte. Koshat me pemë e zarzavate që çon babë Rexha nga fshati, mbushen me trakte, me armë për partizanët. Ato maskohen me kujdes duke i përzier me thasë e rrobe të vjetra të fshatarëve. Një ditë Lymi shkarkoi një gomar me mollë, futi poshtë thassëve pistoleta dhe municion e bashkë me fshatarin, që e solli, e ngarkuan përsëri. Pastaj e nisën në shtëpinë e Ali Mekës¹), e cila ishte një bazë e rëndësishme e Qarkorit të Tiranës dhe qendër ku grumbulloheshin armët e materialet e tjera. Prej këndej me urdhër

1) Simpatizant i Lëvizjes. Dyqanin ku shiste qofte, në rrugën e Durrësit, e ktheu në një bazë ku takoheshin shokët revolucionarë. Shpejt ky qytetar, nën ndikimin e komunistëve, vuri në shërbim të Lëvizjes edhe shtëpinë e tij në Rrugën e Dibrës (sot «Bajram Curri»). Vdiq në vitin 1961.

të Qarkorit ato shpérndaheshin nëpër çetat dhe formacionet partizane të Tiranës.

«Një herë, — tregon Ali Meka, — Lymi me një karrocë me dru, më vjen në shtëpi natën vonë.

— Të solla dru xha Ali, — më tha.

— Çfarë drush, por unë...

Vuri gishtin në gojë dhe unë e kuptova. Diçka fshihej në ato dru. Kur ç'të shoh, dy automatikë dhe një arkë me fishekë.

— Shiko t'i ruash se përgjigjesh, s'ka shaka me këtë punë.

— Po pse kalama më bëre more Lym, — ia ktheva.

— S'bëra keq që të thashë. Pastaj edhe kalmajtë janë rritur o xha Ali. A e di ç'më ndodhi? Një çun i vogël më ndali te rrugica dhe më tha:

— Atje te kryqëzimi janë policët, mos kalo andej, — dhe unë ndryshova rrugën. Edhe mund të më kontrollonin. Tani pas aksioneve e atentateve janë tërbuar dhe çdo gjë e shikojnë me dyshim. Pastaj ai djali më shoqëroi deri atje te rrugica. S'kanë ç'më bëjnë, unë dru kam mor çun, s'kam gjë tjetër — i thashë.

— E di, e di — pëshpëriti djali.

E njoha, më në fund, ishte një nga ata fëmijtë që mirrin në dyqan nëpër shportat me pemë trak-tet, për t'i shpérndarë.

Së bashku me shokë të tjera Lymi merr pjesë në aksionet e ndryshme të njësiteve guerile.

Një nga këto është dhe aksioni për rrëmbimin e një makine shkrimi dhe letrës në policinë që ndodhej në vendin ku sot është Shkolla e Kuqe në

rrugën «Qemal Stafa». Ky aksion kryhej me urdhër të Qarkorit. Një nga shokët u ngarkua të merrte kontakt me njërin nga policët, i cili ishte i lidhur me Lëvizjen. Ai e kishte siguruar materialin në një dhomë nga ku mund të merrej më lehtë. Natën njësiti prej gjashtë vetash zuri vendet e caktuara te ndërtesa e policisë. Lymit iu ngarkua të rrinte në oborr bashkë me një tjetër. Dy të tjerë zunë vend prapa ndërtesës dhe dy u futën brenda. Polici që ishte me shërbim u kap në befasi dhe nuk rezistoi. Dy shokët që u futën brenda nxorrën makinën, letrën si dhe disa armë e municion. Përjashta priste një pajton i ngarkuar dhe gjithë shokët e njësitet u larguan.

Detyra e Lymit ishte që në rast se rezistonin policët të vepronte menjëherë me armë.

Aksioni u krye me sukses.

Pak ditë kishin kaluar nga humbja e shokut të tij të ngushtë Hamit Shijakut, ja tani një lajm tjetër i hidhur.

Hamdi Mëzezi, Ferit Xhajku, Nikolla Tupja me urdhër të Komitetit Qarkor për Tiranën dërgoheshin në Jug për të punuar. Atë mëngjes ishin ndarë, ishin përqafuar me Lymin. Dhe ja në darkë vjen lajmi se i kanë kapur në Fier dhe i kanë sjellë në burgun e Tiranës.

Njëri nga të burgosurit, shok i Lymit, që njihte një gardian të burgut, të nesërmen e fut brenda. E lanë t'i shikojë vetëm nga vrima që shërbente si dritatë.

— I kishin torturuar keq. Feriti sidomos nuk ndihej fare i gjallë, ishte gjakosur nga fytyra, — tha ai.

Lymin nuk e zinte vendi për fatin e shokëve. Ai çdo ditë merrte vesh për torturat, për qëndrimin

e tyre; mori vesh dhe për gjyqin fashist që u bë në Tiranë dhe për dënimin me vdekje në litar. Ekzekutimi u bë në burgun e Tiranës me 13 Maj 1942. Qëndruan si komunistë. Ngritën kokën lart dhe thirrën me një zë: «Ne nuk jemi vetëm. Qindra të tjerë lëmë pas. Rroftë Shqipëria e lirë! Rroftë Partia Komuniste!»

U hidhërua shumë për vdekjen e shokëve, por ndjeu dhe krenari për qëndrimin e tyre burrëror, të papërkulur. Në gjoksin e tij ziente dhimbja për ata dhe urrejtja për armikun. Etja për hakmarrje i rritej e donte të shpërtihente. Shokët e celulës së Partisë iu ndodhën pranë dhe me ndihmën e tyre ai mundi që këtë dhimbje ta kthejë në forcë, të veprojë me shkathtësi, me zgjuarësi e mprehtësi nëpër Tiranën për të çuar në masat idetë e Partisë.

Por ai kishte rënë në sy të armikut, i cili e ndiqte për ta arrestuar.

Pas tradhtisë dhe deponimeve të Ludovik Nikës e Zef Ndojës në prill 1942, të cilët treguan shumë shokë të Partisë e baza ilegale, Lymi ishte i detyruar ta zhvilloonte aktivitetin e tij revolucionar në ilegalitet.

U detyrua ta linte punën në dyqanin e pemëve e të zarzavateve, ta linte dhe shtëpinë e tij, pasi në këto vende ruanin policët dhe spiunët për ta kapur. Ai shpesh maskohej si fshatar që shiste dru, punë e cila i jepte mundësi të lidhej me shokët e tjerë ilegalë si dhe me shokët në çetat partizane, t'u conte armë, trakte e materiale të tjera të Partisë.

Një ditë maji të vitit 1942, ai ndodhej në një bazë në rrugën Fortuzi. Një spion e kishte ruajtur, kishte njoftuar dy policë të kuesturës dhe priste duke u maskuar sa në një derë në një tjetër.

Një banor i kësaj rruge, kur doli në mëngjes

nga shtëpia e tij, e pa spiunin që vinte vërdallë pastaj dhe dy policët. Nuk dinte se kë donin të kapnin. Ai i simpatizonte njerëzit e lëvizjes dhe s'kursej, ndaj qëndroi në gatishmëri.

C'të bënte? Iu afrua shtëpisë pranë së cilës rrinë policët dhe bëri të hynte brenda, por spiuni e ndaloi. Atëherë ai e kuptoi që ruanin dikë në këtë shtëpi. Me siguri do të jetë ndonjë ilegal, — tha me vete. Bëri çmos që të gjente rastin të futej por shtëpia ishte rrrethuar. Në derë ruante një polic, prapa një tjetër dhe spiuni vinte rrëth e rrrotull për të sinjalizuar për çdo gjë. Vendosi që të kalonte nga çatia meqë shtëpitë e tyre ishin pothuaj ngjitur. U fut në shtëpi, hoqi tjegullat kaloi në çatinë e shtëpisë që ruanin. Hoqi dhe atje disa tjegulla dhe që nga tavani nëpërmjet një vrime i foli të zotit të shtëpisë.

— Jeni të rrrethuar por vraponi shpejt të nxirri kë keni brenda.

Të gjithë të shtëpisë qenë zgjuar dhe po i mbështillnin pak bukë Lymit, që ta merrte me vete. Lymi la bukën dhe u ngjit në tavan. Burri e njohu menjëherë. E kush s'e njihte atë në mes të të rinjve të Tiranës? Menjëherë iu kujtua ai djali me trup të mbushur, që shiste pemë në një barakë. Iu përfytyrua ajo ditë kur shkoi bashkë me djalin e tij të vogël të cilit i bleu një kaush qershi. Lymi i donte shumë fëmijët. Ai e mori djalin e ngriti si ngrinte zakonisht fëmijët disa herë lart dhe thoshte:

— Ju do ta gëzoni Shqipërinë!

Ky çast iu kujtua dhe iu hodh në qafë.

— Ti Lym qenke. Duhet të largohesh sa më shpejt.

Lymi nuk e njihte, por s'e bëri veten veç i tha:

— Nga mund të hidhem, — dhe bëri gati pistoletën.

— Kujdes Lym, — tha burri, — të shoh vendin më parë. Prapa shtëpisë ndodhet një polic, ndërsa spiuni sillet vërdallë. Por tani nuk duket.

Lymi s'priti më, kërceu dhe për fat të keq rapanë këmbëve të spiunit që po përgjonte.

Spiunit i erdhi papritur dhe ngriu në vend. Lymi që u rrëzua pak u ngrit dhe çau si vetëtimë pérpara, spiuni qëlloi. Dy policët filluan ta ndjekin me vrap; Lymi në ecje e sipër u kthye e qëlloi mbi ta.

Burri u habit për këtë shpejtësi të Lymit, ai vrapoi dhe u bashkua me disa djem e burra të tjerë që ishin në rrugë dhe kur panë se policët dikë po ndiqnin përpinqeshin tu bëheshin pengesë.

— Më kot e ndjekin, thoshte, a mund ta kapin laraskat shqiponjën?

Lymi mori disa kthesa nëpër rrugicë. Spiuni e policët që e humbën nga sytë pyesnin qytetarët:

— Nga kaloi??!

Por të gjithë heshtnin. Edhe ata që s'e njihnin e kuptionin se ishte komunist, se ata i ndiqnin si të tërbuar, por dashuria për komunistët ishte e madhe, ajo kishte pushtuar gjithë rrugicat gjithë zemrën e Tiranës së kuqe.

Një nga bazat kryesore për Lymin u bë shtëpia e Halil Shyrit¹⁾ djalit të xhaxhait, në rrugën «Gjon Buzuku». Këtu ai zhvilloi aktivitet ilegal. Me ndërmjetësinë e tij kjo shtëpi u bë bazë për strehimin e shokëve Qemal Stafa, Misto Mame, Mihal Duri etj.

1) dëshmor.

Lymi në këtë shtëpi vinte i maskuar herë si fshatar me një gomar me dru, herë si punëtor që merrej me meremetime shtëpish. Megjithatë banorët e afërt të Halilit e njihnin mirë.

Një mbrëmje ai kthehej me një gomar me dru sikur ishte ndonjë fshatar që vinte për t'i shitur. Një grua fqinje e pyeti të zonjën e shtëpisë, kushërirën e Lymit:

— Kush ishte ai që erdhi me gomar.

Ajo iu përgjigj:

— Një fshatar.

Lymi që e dëgjoi këtë dialog e thirri gruan dhe i tha:

— Më njeh kush jam?

— Po, je Lymi, — iu përgjigj plaka.

— Dëgjo, ne jemi bijtë tuaj që luftojmë të huajt që na kanë zaptuar, luftojmë për liri, prandaj se mos...

— Jo, ç'thua mor Lym, asnë fjalë s'na del nga goja, ne jemi nënrat tuaja që ju mbrojmë.

— Nga njerëzit tanë s'duhet të kemi frikë, — i tha Lymi kushërirës.

Shpejtësi dhe mprehtësi

Një shok i Qarkorit i kishte ngarkuar Lymit një detyrë të rëndësishme. Duhej të shoqëronte një partizan për në Çetën e Pezës. Lymi manovroi me shpejtësi. E nxori shokun nga baza ku ishte strehuar dhe po ecnin rrugicës. Në vendin ku rruga «Çerçiz Topulli» del në rrugën e Barrikadave një polic kuesture që e njihte Lymin, dyshoi dhe e ndoqi pas.

«Pse bëri sikur s'më njohu. Ai më njeh mirë mua» — mendoi Lymi dhe bëri gati bombën. Piste veprimet e policit dhe ashtu ndodhi.

Polici pasi eci disa hapa dhe ua bëri me shenjë dy shokëve të tij, e la Lymin të kalojë. Pastaj u kthye t'i sulej pas shpine dhe ta kapë. Por Lymi që e kishte pritur këtë dredhi të policit, bashkë me shokun e tij hyri me shpejtësi në një rrugicë dhe kur ata po vraponin pas tij u hodhi bombën dhe çau nëpër rrugica të ndryshme, por armiqtë i parashikuan lëvizjet e tij. Në qoshe të rrugës e kapën Lymin, ndërsa partizani tjetër u iku nga duart dhe qëndronte me bombën në dorë.

— Qëlllo! — i thirri fort Lymi.

Por si mund të qëllonte? Mirë se do të vriste dy policët por do të vriste dhe Lymin. Megjithatë ai në qoshe të rrugës bëri gati bombën sikur do ta hidhte, policët u trembën, u hutuan dhe Lymi u shpëtoi nga duart e iku në drejtim të kundërt. Ata filluan ta ndiqnin, por partizani bërtiti:

— Mos lëvizni se e hodha.

Policët shtangën në mes të rrugës. Ndërkohe partizani çau rrugicës me vrap nëpërmjet qytetarëve; policët vrapuan në drejtim të tij. Por qëllimi i tyre ishte të kapnin Lymin.

— Nga shkoi, — pyeti polici disa qytetarë.

— Nuk e pashë, — iu përgjigj njëri prej tyre.

— Nga!

— E pashë unë tha një djalë i vogël serioz. — Këtej! — i gënjeu ai duke bërë që të humbisnin gjurmët.

Lymi me partizanin u takua në rrugicën në të dalë të Tiranës dhe e shoqëroi atë deri në Pezë.

NË ÇETËN E PEZËS

Me vendim të Komitetit Qarkor të Tiranës, Myslim Shyri u dërgua në Çetën e Pezës.

— Po largohem nga Tirana, më dërgojnë në çetë. Por unë kam bërë shumë pak. Nuk e qërova atë spiunin e SIMI-it. Sadik Zekthi është bërë shumë i rrezikshëm. Ai gjithnjë ka qenë vegël e push-tuesve dhe e armiqve të popullit. Ka spiunuar e marrë në qafë shumë njerëz të ndershëm; është bërë vegël e Italisë fashiste. Njeh shumë nga shokët tanë, kuadro të Partisë, simpatizantë. Di shumë nga bazat tona të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, përsë të mos e zhdukim? — mendonte.

Ai ishte i shqetësuar ato ditë. Por zhdukja e spiu-nit nuk mund të bëhej sipas dëshirës së njërit apo tjetrit. Partia do të mendonte dhe patjetër do ta qëronte një ditë. Këtë e kishte të sigurtë Lymi, po i vinte keq që ai po largohej në Pezë dhe nuk do të merrte pjesë në këtë aksion. Ai donte vetë ta zbraste nagantin, ta zbraste urejtjen mbi këtë spiun të fëlliur.

Ishte qershor i vitit 1942. Lymi arriti në Pezë. Ishte nga komunistët e parë që dërgoheshin në Çetën e Pezës. Shpejt fitoi dashurinë dhe respektin e shokëve të Çetës e veçanërisht të komandantit trim Babë Myslymit. Ai u bë i dashur, i afërt me fshatarët e Pezës, që e donin si djalin e tyre. Dëgjonin me vëmendje fjalët e zjarrta të tij plot optimizëm pér fitoren, që dilnin nga gjoksi i një revolucionari të vërtetë.

Lymi në çetë kishte shoqëri me Ymer Kurtin¹⁾,

1) Dëshmor, rënë në Jugosllavi në vitin 1944.

një nga partizanët e parë të Çetës së Pezës. Shpesh ai shkonte me të në shtëpinë e tij në katundin Ndraq dhe nënë Merushja e priste njëlloj si djalin e saj.

Në Çetën partizane të Pezës Myslym Shyri ishte përkrahës i flaktë i aksioneve.

Një detyrë e rëndësishme

Pasi kishte disa muaj në Çetën e Pezës, Lymen një ditë e thërrresin në Tiranë dhe i komunikojnë vendimin e Qarkorit të Tiranës për të ekzekutuar spiunin e regjur dhe shumë të rrezikshëm Sadik Zekthin. Lymi e priti me gëzim këtë detyrë të rëndësishme që i ngarkohej; e ndjeu se po i plotësohej një dëshirë e zemrës.

Ishte ditë e diel. Njësiti që do të qëllonte spionin e fëlliqur kishte informata se Sadik Zekthi ndodhej në një dasmë diku në Rrugën e Shëngjer-gjit (sot rruga «Ali Demi») në kthesë, në krye të rrugës që sot quhet «Zonja Çurre». Ata e priten sa doli nga shtëpia. Njësiti zuri vendet e caktuara. Sadiku doli në rrugë qetë-qetë me cigare në gojë. Lymi gjakftohtë i afrohet nja dy metra si për të ndezur cigaren... pastaj me shpejtësi drejton naganatin.

«Në emër të popullit...»

Pam-pam-pam! u dëgjuan tri të shtëna dhe spioni ra përdhe. Shokët e njësirit u shpërndanë në drejtime të ndryshime.

Lymi largohet dhe shkon te motra e tij.

— Po ku je, me se merresh, ku ha, ku jeton, o vëlla, — e pyeste motra e mallëngjyer.

— Me shokët, motër, mos u mërzit.

Lymi merr të nipin në krahë, e përqafon pastaj e ngre lart disa herë.

— Lart, lart, të rritesht burrë, ta gëzosh Shqipërinë e lirë.

Ishte takimi i fundit me motrën e tij. Ajo i jep disa para dhe Lymi niset me vrap për në çetë.

Vrasja e spiunit bëri bujë të madhe në Tiranë. Në shtëpinë e Lymit, në shtëpinë e motrës së tij, spiunët bënin roje, prisnin kur të kthehej që ta kapnin.

— Mos e pritni kot, se ai nuk vjen këtu ta kapni ju? Shkoni e kapeni në mal po ua mbajti, — u thoshte nënë Caja.

Drejtoria e përgjithshme e policisë me shkresën nr. 34246, d. 30 7. 1942, njofton Ministrinë e Brendshme (zyrën politike) për hetimet mbi sabotatorët Myslym Shyri...

Lymi mitralier

Në Çetën e Pezës Lymi ishte mitralier. Armën e tij e përdorte me shkathtësi dhe e ruante si sytë e ballit.

Ishte vjeshtë e vitit 1942. Një njësit i Çetës së Pezës kishte marrë urdhër të marshonte në drejtim të Kavajës. Në Habilaj italianë dhe ballistë përgatiteshin të kapnin pikat dominuese për të sulmuar Çetën e Pezës. Filloi marshimi natën. Njësiti niset nga Çikalleshi, kalon në Leshtenj dhe merr drejtimin për në Habilaj.

Pasi arritën në vëndin e caktuar të gjithë shokët u ulën të pushojnë.

Lymi e kontrolloi mitralozin. Diçka mungonte. Mungonte çelësi bashkues. Ky çelës pengonte veprimin e mitralozit. Beteja me armiqtë mund të filloente së shpejti. Ai s'kishte q'të priste. I thotë shokut të tij, niset me vrap dhe si vetëtimë çan errësirën e natës. Menjëherë vete në vendin ku i kishte rrëshqitur këmba, gjen çelësin dhe kthehet me një frymë pranë shokëve, pa e marrë vesh asnjë përveç shokut të tij.

Tani mitralozi ishte në gatishmëri të plotë. I ndritën sytë nga gjëzimi që kishte arritur në kohë. S'pati kohë të ulej se u dha urdhri që të kapej me shpejtësi kodra Leshtëçollak dhe të vendosej aty mitralozi. Kodra ishte një pikë dominuese nga ku vrojtohej deri në Kavajë dhe ku dukeshin si në pëllëmbë të dorës lëvizjet e italianëve dhe të ballistëve të Irfan Ohrit. Për kapjen e kësaj kodre vepronte edhe armiku. Ballistët donin që ta kishin si pikë dominuese nga ku të vepronin. Shpejtësia ishte vendimtare, ishte një faktor i fortë që përcaktonte fitoren.

Me të marrë urdhrin e komandantit të njësitet, Lymi vetë i tretë, me mitralozin e rëndë në krah, i vërsulet të përpjetës. Djersët i rrjedhin rrëke, zemra i rrihte fort, por fitorja i buzëqeshte. Arrin i pari në kodër ku ndien flladin e freskët t'i fshijë djersët e ballit e t'i përkëdhelë fytyrën.

Eshtë më e fortë pushka jonë se topi i armikut

Lymi fitoi një dashuri të madhe në popullin e Pezës. Kushdo i hapte derën. Ai dinte të bisedonte

me njerëzit, të hynte në zemrat e tyre. S'kishte shumë shkollë, porjeta plot me halle e vështirësi, përpjekje e luftë ishte bërë një shkollë e vërtetë. I kishte të qarta idetë, perspektivën. Qenia e tij në Parti, mbledhjet e organizatës, literatura, megjithëse e paktë, që kishte lexuar, bisedat me shokët më të ngritur kishin formuar te ai tiparet e një komunisti të vërtetë. Ai fliste me gjuhën e popullit, çdo çështje e svaronte me qartësi politike e ideologjike. Një natë në shtëpinë e një fshatari pezjak vazhdoi gjatë biseda. I zoti i shtëpisë nuk ishte optimist për luftën.

— Ju jeni pak... — thoshte ai.

— Por jemi të bashkuar, pastaj me ne është gjithë populli, s'jemi vetëm; — i thoshte Lymi.

— Po ata kanë armë, kanë topa, more Lym, si do t'i bëni ballë.

— Ti po e sheh mirë si po fitojmë. Ata me top, por ne i kemi shpartalluar sa herë jemi ndeshur me ta. Është më e fortë pushka jonë se topi i tyre.

Pas ca ditësh në shtëpinë e këtij fshatari shkuan disa partizanë të tjerë.

Ai i pyeti menjëherë:

— Ku është Lymi? Përse nuk ka ardhur?

— Lymi vajti në Dumre, — iu përgjigjën. — E dërgoi Partia atje.

— Ai ishte me të vërtetë komunist, ishte i vendosur dhe me njerëz si ai do ta fitoni luftën, u binda plotësisht — u tha fshatari pezjan.

NË ÇETËN E DUMRESË

*Në malet e larta,
në borë e stuhi,
doli Myslym Shyri
në luftë për liri*

(Këngë popullore)

Më 28 shkurt 1943 me vendim të Partisë Myslym Shyri dërgohet në çetën e Dumresë. Ndahet me mall nga shokët e tij. I urojnë rrugë të mbarë dhe suksese. Detyra të reja e prisnin në Dumre: duhej punuar për organizimin e këshillave nacionalçlirimtare, për të sqaruar popullin, për të rritur frymën e besimit e të mobilizimit për luftë, për të shpartalluar propagandën reaksionare të «Ballit», për të asgjësuar kudo pushtetin fashist e për të vendsur pushtetin e ri.

Limi merr rrugën nëpër të ftohtë e borë. Nata e zë në fshatin Fikas të Elbasanit. Atje fle në shtëpinë e një fshatari që ishte bazë e sigurt, e ku ishin strehuar vazhdimisht partizanë. Fshatarit i bëri për-

shtypje shumë Lymi. Për këtë ai flet me fshatarë të tjerë dhe me partizanë që takon pas Lymit. «Më ka bërë përshtypje ai tiranasi, Lymi. Sa i thjeshtë, gojëmbël, sikur ishte rritur me ne, i dinte hallet tona, fliste për ne, fliste për të ardhmen sesi do të bëhet Shqipëria pasi të shporrim fashistët, ballistët dhe zengjinët. Pushtetin do ta marrin të varfërit, — më pat thënë».

Pas një udhëtimi të gjatë e të vështirë arrin në Shpat. Takohet me shokët Gjokë Doçi, Siri Kodra etj. E presin me ngrohtësi komunistët e çetës si vëllanë e tyre, e presin të 25 pjesëtarët e çetës. Me ardhjen e Lymit, në çetë u bënë pesë komunistë; ajo tanë do të kishte udhëheqjen e celulës së Partisë, komunistët do t'i kishte gjithnjë në ballë.

Lymi punoi në celulë dhe pastaj në çetë vendimet e Konferencës së Pezës dhe dha udhëzime të hollësishme për detyrat që kishin komunistët dhe gjithë partizanët për organizimin e këshillave nacionalçirimitare.

Ai ishte shumë i përpiktë në zbatimin e direktivave dhe të udhëzimeve të Partisë dhe pikërisht për këtë i propozoi celulës që çdo komunist të mbante në patronazh 5-10 partizanë dhe me ta të punonte vazhdimisht vendimet e konferencës, me qëllim që çdo partizan të ishte në gjendje për të punuar me popullin, për t'i treguar atij qëllimin e madh të Partisë. Çdo mëngjes kur partizanët dhe komunistët dilnin nga bazat, Lymi i pyeste se çfarë problemesh u kishin dalë në biseda me fshatarët dhe si i kishin trajtuar ato.

Ai nga Shpati i Parë shkonte në Shpatin e Dytë dhe në Dumre për të organizuar këshillat. Së bashku me komunistët e tjerë luftonte me këmbëngulje që

zgjedhjet të ishin sa më demokratike dhe në këshill të zgjidheshin njerëzit më të devotshëm, që ishin të lidhur me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe që kishin besim në fitore.

Pavarësisht se s'kishte funksion atë e konside-ronin dhe e respektonin si udhëheqës të tyre, si komisar. Gëzonte autoritet, dashuri, respekt te të gjithë partizanët.

Një aksion i rëndësishëm në të cilin ndërmjet të tjerëve u shqua edhe Lymi ishte ai për shpartallimin e postës së xhandarmërisë në fshatin Gjinari.

Më parë ishin marrë të dhënët. Në postë kishte një efektiv prej 18 vetësh me në krye një marshall, i cili ishte dhe komandanti i postës. Posta, përvëç mbrojtjes natyrore, ishte e siguruar dhe me llogore, kishte një mitraloz të rëndë dhe dy mitraloza të lehtë.

Në mbledhjen e celulës u vendos që rrëthimi të bëhej natën, të kapesh roja ose të asgjësohej me thikë. Pastaj një grup shokësh të futeshin në postë për t'i kapur në befasi. Në grupin e kapjes apo të asgjësimit të rojes, u caktuan dy komunistë, Siri Kodra¹⁾ dhe Naum Panxhi²⁾, ndërsa në grupin që do të sulmonte brenda në postë, me këmbënguljen e tij, u ngarkua Lymi me katër partizanë të tjerë.

Ishte natë e errët e ftohtë. Era frynte me zhurmë, duke maskuar kështu sadopak zhurmën e çetës që po drejtohej drejt vendit të aksionit.

Disa metra larg postës, ndaluan. Siriu dhe Na-

1, 2) dëshmorë.

umi iu vërsulën rojes, e kapën, i lidhën gojën dhe e çarmatosën. Lymi me shkathtësi e mbërtheu për gurmazi përgjegjësin e rojes, që qëndronte te dera e postës.

Pastaj hyri brenda, po njëri nga xhandarët që dëgjoi zhurmën e hapave të Lymit, siç ishte shtrirë nxori pistoletën që e mbante nën jastëk dhe shtiu. Plumbi për pak e goditi Lymin në kokë. Ndërkohë u futën brenda dhe shokë të tjerë të çetës. E kapën xhandarin, i morën armën dhe të tjerëve iu bë thirrje të dorëzohen.

Xhandarët u ngritën nga shtratet dhe me duart lart qëndronin në këmbë duke u dridhur.

U morën në dorëzim të gjitha materialet. Në postë u vendos çeta. Xhandarëve u foli Lymi; ai u shpjegoi qëllimin e luftës sonë. U bëri thirrje shqiptarëve të qëndronin në çetë, italianët i porositi të hiqnin dorë nga qëndrimi në karabinieri e të ktheshteshin në shtëpitë e tyre. Por në këtë aksion Lymi e teproi me ndonjë veprim të tij, sepse ndonjëherë ishte dhe i nxituar, prandaj mbledhja e celulës së Partisë i tërhoqi vëmendjen që pa humbur nisiativën të ishte më i matur në veprime.

Në qershori të vitit 1943 u bë riorganizimi i çetave të Shpatit të Parë, Shpatit të Dytë dhe Dumresë, duke u inkuadruar në Batalionin e Dumresë. Lymi u ngarkua me detyrën e zëvendëskomisarit të Çetës së Shpatit të Parë.

Aksioni i madh që mendoi celula e Partisë të kryente Batalioni i Dumresë ishte tërheqja e materialeve ushtarake nga magazina e një reparti ushtarak në rrugën Peqin-Elbasan, afër katundit Papërs-Sollak dhe djegia e depos.

Një ditë më parë u dërgua një grup për të parë

kushtet dhe rrethanat ku do të bëhej aksioni. Në këtë grup bënte pjesë edhe Lymi. Depot ishin ndërtuar në një vend shumë strategjik; ato përveç mbrojtjes natyrore ishin siguruar dhe me dy bunkerë me beton, ku ishin vendosur dy mitraloza; mbroheshin nga dy toga ushtarësh italianë, përveç nëpunësve e mekanikëve, të cilët ishin të gjithë të armatosur. Pasi hetoi mirë e mirë gjendjen e forcave dhe të vendit, grupi u kthye në Shpat dhe u bë plani i sulmit.

Batalioni do të merrte pjesë i gjithë në aksion. U krijuan tre grupe; në të parin që përbëhej prej 15 vetësh, bënte pjesë edhe Lymi. Ky grup kishte për detyrë të asgjësonte rojen në hyrje dhe të sulmonte me shpejtësi drejt fjetoreve për t'i kapur në befasi forcat rezervë, që mund të vinin në ndihmë të rojeve. Grupi i dytë dhe i tretë kishin për detyrë të sulmonin bunkerët dhe të kapnin ose të asgjësonin rojet në bunkerë në befasi dhe pa hapur zjarr.

Ishte natë qershori. Hëna fshihej sipër reve të dendura, duke lënë errësirën që ishte aq e nevojshme për një aksion të tillë.

Partizanët i afrohen barkas rojes në hyrje dhe e asgjësojnë atë me thikë. Në këtë kohë grupet partizane asgjësojnë rojet e tjera. Vetëm njëri, me mitraloz nga bunkerë, arriti të zbrazë një breshëri, por u asgjësua shpejt me thikë. Në kohën që u zbraz mitralozi armik, Lymi me shokët ndodheshin në fjetoret dhe në zyrat ku flinin oficerët dhe drejtori i depos.

Armiqtë sa u përmendën nga zbrazja e mitralozit, u gjendën para partizanëve që u bërtisin:

— Dorëzohuni!

Ata zbrisnin nga krevatet dhe ngrinin duart, por

dy prej tyre rrëshqitën me shpejtësi dhe u fshehën nën krevat. Ishin të veshur dhe në dorë mbanin pistoletat gati për të qëlluar; nuk dorëzoheshin. Kurse një italian, që nuk ishte ngritur, por kishte mbuluar kokën me batanie nga frika, kishte nxjerrë grushtin jashtë e therriste italisht:

«Morte fashizmo!», «Viva i partixhani!» (Vdejkje fashizmit! Rrofshin partizanët). Kur i ngriti batanien njëra nga shoqet partizane, që merrte pjesë në aksion, ai i tmerruar thirri: «mama mia», «anke le done» (nëna ime, edhe gratë).

Ata që u dorëzuan i nxorën jashtë, kurse atyre të dyve që ishin nën krevat iu bë thirrje të dorëzohen se do t'i vihej zjarri ndërtësës. Ndërsa po dilte, njëri prej fashistëve qëlloi dhe e plagosi një partizan në këmbë. E kapën dhe e lidhën. Tjetri e hodhi pistoletën dhe u dorëzua.

U morën në dorëzim materiale luftarake, veshmbathje, kopertona dhe kamardare, që nevojiteshin për opinga; pastaj depos i vunë zjarrin. Morën aq material sa mund të mbanin. Të gjithë u ngarkuan rëndë. Batalioni u tërhoq pa asnje humbje.

Dashuria për shokun

Një mbasdite qershori, në Shpat ku ndodhej Lymi erdhi për ta takuar një shok i tij. Ai kishte qenë ngarkuar me detyrë partie në qarkun e Elbasanit. Kur erdhi në Çermenikë vendosi të takohej me Lymin, shokun e tij të fëminisë, shokun e aksioneve në qytetin e Tiranës, por në çast i vjen urdhri për të kaluar në Vlorë. Megjithatë ai përpinqet ta takoj patjetër Lymin para se të niset.

Ishte lagur nga shiu që kishte rënë, këpucët i kishte të hapura dhe këmbët i kullonin ujë. Atë natë fjetën në shtëpinë e një fshatari në Shpat. Të dy shokët kujtuan kohën kur endeshin pa punë, pastaj aksionet me njësitin gueril etj. Fshatari ia thau rrobat, ia qepi këpucët me spango.

Të nesërmen në mëngjes kur u bënë gati për t'u veshur, Lymi i zgjati këpucët e tij. Ishin këpucë ushtarake të reja. Shoku i tij nuk deshi t'i pranonte por Lymi nguli këmbë.

— Merri, ty të duhen, ke për të bërë rrugë të gjatë gjer në Vlorë. Merri, armikut ia kemi marrë dhe do t'i marrim përsëri.

Ia dha dhe vetë veshi këpucët e arnuara me spango.

U ndanë duke u përqafuar me mall dhe me shpresë se do të takoheshin përsëri.

Propozim me shumë rëndësi

Lymi nuk ishte vetëm një luftëtar trim, njeri i sakrificës, por edhe një punëtor i vërtetë partie, njeri i mendimit, pavarësisht që nganjëherë rrëmbehej. Për këtë e këshillonin shpesh shokët e celulës.

Në aksionin për shpërndarjen e të dhjetave në Shtërmen, Gjyral dhe Shalës, Lymi propozoi që 20-30 kuintalë misër t'u liheshin në dispozicion këshillave nacionalçlirimtare dhe të shpërndaheshin sipas nevojave që kishin fshatarët. Me këtë ndihmoheshin ata të kapërcenin dimrin e vështirë dhe mungesën e madhe që kishin për bukë. Po kështu Lymi pro-

pozoi që në kohën e prashitjes së misrit dhe në korrjen e të lashtave t'u shkonin në ndihmë fshatarëve. që kishin pak krahë pune, pleqve dhe të sëmurëve. Këto propozime u vendos të viheshin në jetë.

Mbas disa ditësh çetës i vjen një letër nga Qarkori i Elbasanit i cili i ngarkonte një mision shumë të rëndësishëm Çetës së Shpatit. Duhej të sulmohej patjetër kuestura e qytetit, që ishte një çerdhe tradhtarësh e urrehej nga populli për më tepër se armiqtë kishin rënë në gjurmët e mjaft shokëve komunistë, që vepronin në qytet. Kuestura kishte grumbulluar dokumente, fotografi dhe ishte në ndjekje të komunistëve **dhe të anëtarëve të njësive guerile.**

Të parët që u vunë në krye të këtij aksioni ishin komunistët.

Çeta afër mesnatës ndodhej në Elbasan, fshehtazi iu afrua kuesturës, e rrëthoi atë dhe zuri pozicionë. Pas pak partizanët qëlluan me shishe me benzинë nga dritaret. Ndërtesa mori zjarr. Në fillim mori zjarr katì i dytë. Policët e kuesturës zbritën në katin e parë dhe u munduan të çajnë rrëthimin por predhat e armëve të partizanëve i lanë në vend. Kuestura u dogj.

NË BRIGADËN I SULMUESE

Komisar batalioni

«Garanci për kryerjen me ndër të detyrave në brigadë ishin komunistët. Komiteti Qendror dërgoi aty 70 anëtarë partie. Me zgjedhjen e tyre u mor vete Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha»¹⁾.

Lymi ishte ndër ata që e ndjenin veten krenar për këtë ndër që u bëhej.

Kur i komunikuan vendimin e Komitetit Qendror dhe të Shtabit të Përgjithshëm për emërimin si komisar i Batalionit të dytë, Lymit iu duk e pasueshme. Mua komisar batalioni? Ai s'e kishte menduar kurrë se Partia do t'i ngarkonte një detyrë kaq të rëndësishme, detyrë që kërkonte përgatitje të mirë ideopolitike.

«Ky është një besim i madh që ka Partia te unë dhe unë do ta justifikoj dhe me gjak po qe nevoja» qe shprehur Lymi.

1) «Shpresë për popullin, tmerr për armikun», 1977, faqe 16.

Shokët e Dumresë e të Shpatit, me të cilët kishte ardhur ishin në Batalionin e katërt. Erdhi çasti të ndahej me ta dhe do të shkonte në Batalionin e dytë që ishte përqëndruar në Shtyllë.

Qenë çaste mallëngjimi; shokët e uronin, por u vinte keq që ndaheshin prej tij. Përqafohet me Gjo-kën, Siriun, etj.

— Përsëri në një brigadë jemi, kudo kryejmë detyrën e Partisë, — u tha Lymi dhe u nis bashkë me një shokun e vet komunist.

Shokët e Batalionit të dytë që ishin vendosur në Shtyllë e priten me ngrohtësi komisarin e tyre.

Dhe erdhi dita e gjëzuar, dita e 15 gushtit 1943; Lymi qëndron në krye të Batalionit të dytë, si komisar i tij, rreshtuar në fushën e Makërzës, në juglindje të Vithkuqit të Korçës. Në zemrën e tij vlonët një gjëzim i papërshkruar, vendosmëria për të kryer me nder këtë detyrë që i ngarkohej. Si çdo partizan dhe ai e ndiente veten krenar në rreshtat e kësaj brigade heroike.

Ja shoku Enver Hoxha, shokë të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçirimitar, të Shtabit të Përgjithshëm marrin pjesë në inaugurimin e Brigadës I Sulmuese. Fjalët e shokut Enver Hoxha i ndezën zjarr zemrat e partizanëve, u rritën besimin e optimizmin për fitore:

«Bëhuni tmerr për armikun dhe shpresë për popullin»¹⁾) Fjalët e fundit u ngulitën thellë në mendjen e çdo partizani.

1) «Shpresë për popullin, tmerr për armikun», 1977, f. 20.

Pastaj në emër të partizanëve foli shoku Mehmet Shehu:

«*Betohemi se do ta bëjmë Brigadën I tmerr për fashizmin dhe shpresë për popullin, do të hidhem nga aksioni në aksion dhe do të korrim fitore pas fitoreje, do t'u japim grusht pas grushti okupatorëve fashistë dhe tradhtarëve të popullit tonë*»¹⁾.

— Besim të madh pati te unë Partia. Më ngarkoi me detyrën e komisarit të batalionit. Por prova më e madhe do të jetë veprimitaria ime në radhët e brigadës para së cilës dalin detyra të mëdha e të rënda për t'i kryer — mendonte Lymi dhe iu vu punës me mish e me shpirt deri në fund.

Populli në këngën e tij thotë:

*Trim i batalionit,
shkove komisar,
Ti o Myslym Shyri,
Në Brigadën e Parë.*

Komisar batalioni vërtetë detyrë e vështirë për një të ri si Lymi, por Partia e kishte peshuar mirë kur e kishte emëruar. Përvoja e tij në jetë me punët e Partisë që nga krijimi i saj e kishin formuar atë dhe do ta kalitnin akoma më tepër nëpër fushat e betejës, duke nxjerrë në pah dhe tiparet e një komisari trim e të zot që s'e ndan kurrë fjalën nga veprat.

Komandanti i brigadës kishte formuluar në një udhëzim të posaçëm normat e moralit partizan dhe disa udhëzime të tjera që flisnin për rritjen e ndërgjegjes së partizanëve, për forcimin e përgatitjes

1) «Shpresë për popullin, tmerr për armikun», 1977, f. 20.

së tyre politike e për mbajtjen kurdoherë lart të moralit partizan. Detyra e tij si komisar ishte shumë me përgjegjësi. Duheshin zbatuar me përpikmëri këto kërkesa që shtronte Komiteti Qendror i Partisë dhe Shtabi i Përgjithshëm.

Që në ditët e para në Batalionin e dytë të Brigadës I Sulmuese ranë në sy karakteristikat e shkëlqyera të një njeriu të ndershëm dhe revolucionar. Me këto cilësi Lymi shpejt, nisi t'i bëjë për vete të gjithë shokët, bëri që ata ta duan dhe ta respektojnë.

Aksioni i parë i brigadës ku mori pjesë dhe Batalioni i dytë ishte prita e Barmashit. Pas luftimesh të ashpra që u kurorëzuan me sukses, batalionet u zhvendosën përsëri në pyje, afër Shtyllës.

Lymi që në fillim u shqua për guxim, për trimëri, ishte i drejtë e parimor. Disiplinës së Partisë, — thoshte ai, — duhet t'i nënshtrohen të gjithë njëlloj. Në organizatën e Partisë, ai diskutonte, bënte autokritikë, jepte llogari si çdo komunist, por dhe kritikonte këdo, ishte i papajtueshëm me të metat.

Në luftën e Vithkuqit

Pas aksionit të parë në pritën e Barmashit, nga data 25 deri 29 gusht 1943, Batalioni i dytë i inkua-druar me brigadën I zuri një front në lindje të fushës së Makërzës. Përpjesëtimi i forcave ishte shumë i madh. Ai u ndesh me rreth 2000 fashistë italiane.

Italianët përdorën të gjitha llojet e armëve, që nga automatiku, artileria, aviacioni. Terreni ishte i pënjohur. Megjithatë partizanët luftonin me heroi-

zëm. Lymi e ndjeu se duhej të ishte jo vetëm komisar i zoti por dhe luftëtar, që të jepte shembullin personal në situata të vështira. Ai çau përpëra në krye të kompanisë, që luftonte me vëtmohim për të marrë pozicionet e zëna prej fashistëve.

Partizanin e parë të plagosur e tërroqi vetë, duke e mbajtur në krahë derisa e largoi nga vija e parë e zjarrit. Kështu ai fitoi shpejt, që në këtë betejë, simpatinë e partizanëve.

Në këtë betejë partizanët e Batalionit të dytë korrën fitore të plotë mbi armikun, megjithëse ishte në numër më të madh dhe i armatosur rëndë. Kjo erdhi në saje të punës së mirë të Partisë për formimin e një morali të lartë te partizanët, në saje të shembullit personal të komunistëve dhe luftës heroike të partizanëve.

Në pritën e Xhyrës Lymi merr vetë drejtimin e kompanive

Dy kompani të Batalionit të dytë bashkë me Batalionin e tretë, një kompani të Batalionit të parë, kompania kundërtanke dhe e mortajave si dhe Çeta e Bërzheshtës natën duke gdhirë 15 qershorin zunë një pritë në afërsi të Xhyrës në të dyja anët e rrugës automobilistike Pogradec-Elbasan. Ishte zgjedhur vendi më i përshtatshëm në afërsi të Librazhdit, atje ku xhadeja dredhonte pranë shkëmbinjve të thepisur, të cilët shërbenin si pozicione për partizanët.

Lymi ishte në vijën e parë të frontit.

Ai mori masa që të zbatoreshin me përpikmëri urdhurat. Prita në radhë të parë kërkon disiplinë. Asnjë zhurmë, asnjë lëvizje. Sytë e partizanëve ishin

ngulur mbi rrugë. Megjithëse të lodhur, pa gjumë, e qepallat e rënda kërkonin t'u mbulonin sytë, qëndronin të gjithë me vendosmëri.

Rreth orës 9 u dha urdhri që çdo luftëtar të ishte në gatishmëri se po vinin makinat.

Sapo ato u futën në darën e pritës, filloi breshëria e plumbave. Qëllonin partizanët në mënyrë që asnjë predhë mos të shkonte kot. Armiqtë zbritën nga të pesë makinat dhe u dorëzuan. Ishin 69 ushtarë italianë. Ushtarët, gjithë armatimi dhe materialet e tjera u morën në dorëzim, ndërsa makinave iu vu zjarri.

Aksioni përfundoi mirë. Por u dha urdhri që partizanët të mos lëviznin nga pozicionet që kishin zënë. Nuk kaluan më tepër se 15 minuta, kur u dëgjua uturima e makinave armike. Ishin rreth 60 autoblinda me ushtarë gjermanë. Kur panë tymin e makinave që digjeshin, ndaluan, zbritën dhe zunë pozicionet nëpër shkëmbinj.

U dha urdhëri për të sulmuar nazistët. Lufta vazhdoi 7 orë, duke i shkaktuar armikut shumë të vrarë; mes tyre dhe një oficer.

— Përpara, shokë, dëgjohej thirrja e partizanëve. Në këtë luftim nuk pati asnjë të vrarë.

Partizanët atë natë e kaluan në pyll. Aty erdhën fshatarë të fshatrave përqark për të sjellë ushqime dhe për të festuar fitoren bashkë me partizanët. Lymi ndodhej mes tyre dhe u fliste me optimizëm e besim për fitoren.

Në afërsi të Tiranës

Batalioni i dytë në përbërje të brigadës iu afrua Tiranës. Në agim të 1 tetorit Lymi ndodhej me grupin prej 15 luftëtarësh në pritë pranë Urës së Farkës. Në mëngjes ky grup asgjësoi një kamion me ushtarë gjermanë. Lufta qe e ashpër por zgjati pak kohë.

Pas dy ditësh Lymi merr pjesë në sulmin që përsëritet; këtë radhë me forca më të shumta, me dy kompani të këtij batalioni. Gjermanët pas goditjes së parë e kishin përforcuar truprojen e Urës së Erzenit me forca të reja dhe me tri autoblinda të tjera.

Sulmi filloi natën. Në këtë përleshje u vranë jo më pak se 15 armiq. Por nazistët rigrumbulluan forcat. U krijua një gjendje e rrezikshme. Hutimi të conte në disfatë, por luftëtarët trima nuk e humbën toruan dhe u hodhën në kundërsulm të rrufeshëm. Armiqtë u gozhduan në vend. Në këtë kohë u bë tërheqja e partizanëve në mënyrë të rregullt.

Në betejë u plagosën dy partizanë: Hysen Ali Aranitasi, intendent i batalionit dhe Nevruz Xhemali, partizan.

Lymi e mbajti në krah Hysenin. Atij i ishte çarë barku nga një predhë bombe dhe mbante në duar zorrët që të mos i dilnin jashtë.

«Mos u merrni me mua, — vazhdoni luftën, — thoshte Hyseni. Unë e di se do të na e merrni hakun! Unë e di se ne do të fitojmë. Rroftë Partial!»

— Hysen! — thirri Lymi, po ai e përshëndeti për të fundit herë dhe uli kokën. Lymi e përqafoi, ndjeu dhimbje, një dhimbje të fortë.

— Do ta marrim hakun, Hysen! — u betua Lymi.

Pas tërheqjes batalioni u përqëndrua në Priskë. Lymi mbloodi batalionin dhe u foli shokëve për heroizmin e dy partizanëve që ranë në fushën e betejës.

Që nga Priska ai vështronë Tiranën të mbuluar me një tis të zi që s'e linte të dallonte mirë rrugët, të dallonte lagjen e tij, bazat ku kishte jetuar. Kishë mall të takonte motrat, vëllezërit, por ai donte ta shihte Tiranën të lirë.

— Sa dëshirë do të kisha të merrja pjesë në çlirimin e plotë të Tiranës, — i tha Lymi një shokut që kishte pranë, — sot për sot ne do të asgjësojmë vetëm postën e xhandarmërisë, por shpejt do të vijë edhe ajo ditë.

— Vallë do ta kemi atë fat — i tha shoku.

— Patjetër, — vazhdoi Lymi, — dhe ne do të na takojë të marrim pjesë në betejën e madhe për çlirimin e kryeqytetit tonë të dashur, dhe kjo ditë s'do të jetë e largët.

Në qarkun e Gjirokastrës

Në dhjetor të vitit 1943 Brigada I Sulmuese ka-loi në zonën e Gjirokastrës.

Një javë rresht udhë, të lodhur nga luftimet natë e ditë. Vështirësi të mëdha kapërcenin partizanët, ecnin dhe zbathur, zhveshur, ngarkuar me armë e municion. Gjatë gjithë operacionit partizanët hanin apo s'hanin një herë në ditë, një çikë bukë misri me qepë apo djathë, dhe asgjë më tepër.

Gjatë kësaj periudhe të dimrit të ftohtë detyrë e rëndësishme për organizatën e Partisë ishte kalitja e luftëtarëve të rinj. Duhej interesuar që nga veshmbathja, pajisja, por në radhë të parë duhej të qartësoheshin tek ata detyrat e tyre, duhej kalitur guximi, durimi ndaj vështirësive dhe besimi në fitore. Edhe në këtë drejtim Lymi si komisar i batalionit punoi pa u lodhur.

Nga fundi i janarit kthehet në qytetin e Gjirokastrës, e cila ishte e lirë në duart e partizanëve.

Sa gëzohet Lymi që shikon një qytet të lirë, pa fashistë, pa ballistë, ku populli merr frymë lirisht. Kudo në çdo shtëpi, në ballin e pleqve dhe të të rinjve, të fëmijëve ndrit gëzimi, këngët partizane ushtojnë kudo. Festë ka gjithë qyteti. Nëpër shtëpitë i presin krahëhapur partizanët.

Lymi kaloi dy net në qytet; një natë në shtëpinë e një gjirokastriti ku gadi e gdhiu. Ai fliste shtruar. Biseda e ngrontë e tërheqëse e bëri për vete qytetarin. Kështu me muhabet për luftën dhe për situatën kaloi mesnata.

Shoku që ishte bashkë me Lymin i tha si me shaka:

— Me ty nuk është për të vajtur nëpër baza se mbetesh pa gjumë.

— E po duhen sqaruar njerëzit, ne s'shkojmë vetëm për të pushuar, — iu përgjigj Lymi. — E di, po mos të kishin parë ty që t'u myllën qerpikët, të zotët e shtëpisë do të kishin harruar të na shtronin për të fjetur.

— Mua më vinte gjumë dhe doja të pushoja në atë shtëpi që ishte mjaft e pastër.

— Megjithatë fjetëm mjaft, — tha Lymi dhe

i hodhi një vështrim qytetit dhe malit të Lunxhërisë nga ku përshëndeste dielli.

Në vendin më të rrezikshëm

Në ato ditë shkurti të vitit 1944, gjermanët kishin ndërmarrë Operacionin e Dimrit dhe vritnin këdo që gjenin përpara, gra, pleq e fëmijë. Një pjesë e tyre kishte marrë rrugën drejt Zagorisë. Në Zgori ishin grumbulluar shumë fshatarë, të cilët qenë strehuar në këtë zonë të thellë ku forcat gjermane nuk kishin depërtuar. Një kompani e Batalionit të dytë ndodhej në Libohovë kurse dy kompanitë në njérën nga të cilat ishte dhe Lymi ishin përqëndruar në katundin Suhë. Nga vrojtimi që u bë, u vërtetua që gjermanët po afroheshin. Ata donin të merrnin Suhën dhe nëpërmjet grykës së Selcës të dilnin në Zagori.

U mendua që një skuadër të fshihej afër rrugës dhe kur gjermanët të suleshin në drejtim të Suhës ku ishin forcat partizane, skuadra t'i jepte armikut goditje pas shpine. Por ky aksion i skuadrës ishte i vështirë dhe me rrezik pasi vazhdimisht vinin dhe forca të tjera gjermane nga kalaja e Shëndriadhës. Armikut iu bë një goditje e befasishme ku lanë kokat më shumë se 30 vetë.

Mbas veprimeve në Suhë kompania u tërhoq në grykë të Selcës, dy kilometra prapa, ku ishte një vend i pashkelshëm të cilin gjermanët s'e kalonin dot. Koha ishte e ftohtë, binte shi me erë. Përroi që ndante Libohovën me Suhën ishte fryrë nga ujërat dhe ishte e pamundur të kalohej. Aty i priten dhe forcat e tjera të gjermanëve dhe u dhanë një grusht

të fortë. Ky veprim luftarak i kompanisë pati rëndësi të madhe, pasi depërtimi i gjermanëve në Zagoni do t'i shkaktonte mjaft dëme popullsisë.

Me urdhër të komandantit të brigadës Batalioni i dytë do të zbriste në Përmet për të marrë detyrë tjetër.

Një kompani mbeti në Libohovë.

Një gëzim i madh

Më 7 shkurt Brigada I u mblodh në Vërzhezhë për të zhvilluar konferencën e saj të pestë. Lymi si të gjithë shokët ishte i shqetësuar, mungonte një kompani e Batalionit të dytë, e cila ishte shkëputur gjatë operacionit armik dhe kishte mbetur në Libohovë. Nuk dihej asgjë për të. Vallë ç'do të ketë ndodhur me këtë kompani?

Pas pak erdhën dy partizanë. Lymi i njoju që ishin të batalionit të tij. Zemra i rrihte fort. Ata dukeshin të lodhur e të dërrmuar. Ngritën grushtat lart e përshëndetën: Vdekje fashizmit!, pastaj i dhannë një letër komandantit të brigadës.

Çdo të jetë shkruar në atë letër?... — mendonte me ankth Lymi.

Shoku Mehmet Shehu i puthi njërin pas tjetrit të dy partizanët... pastaj kumboi madhështor zëri i tij:

— Shokë, kompania e Batalionit të dytë që na ishte shkëputur në Libohovë është e gjitha shëndosh e mirë. Jo vetëm kaq, por ajo ka luftuar me një mijë ballistë të shoqëruar nga gjermanë në Hllomo e në Polican, i ka shpartalluar krejt dhe e ka çliruar

*gjithë zonën nga armiqtë. Pushka e Brigadës I Sulmuese kërcet kudo!*¹⁾

Një çast jashtëzakonisht mallëngjyes, dy korriërt e kompanisë sulen drejt te komisari i batalionit dhe pastaj te shokët e tyre. Përqafoheshin dhe nuk çmalleshin dot.

Të pasnesërmen arriti kompania e Batalionit të dytë.

Batalioni i dytë në përbërje të brigadës mori pjesë në spastrimin e Nahijes së Beratit dhe të Tomoricës nga armiqtë. Kapërceu qafën e Devrijes, atë të Kulmakut dhe doli në Tomoricë. Ballistët ua mbathën me të katër në drejtim të Beratit dhe të Gramshit.

Fshatrat çliroheshin njëri pas tjetrit. Atje organizoheshin konferenca politike me fshatarët e ngriheshin këshillat nacionalçirimtare, grumbulloheshin ndihma për partizanët, zhvillohej një agitacion politik i gjerë. Për fshatarët e Nahijes, të Tomoricës e Sulovës ishte ditë feste e gjëzimi. Fjalët më të mira thoshin ata për partizanët e partizanet për komandantët e komisarët.

Në inkursionin e madh

Lymi si komunist dhe si komisar mori pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme të anëtarëve të Partisë të batalionit të parë, të dytë e të tretë që u bë më 4 dhe 20 shkurt 1944.

1) «Shpresë për popullin, tmerr për armikun», 1977, f. 225.

Ai dëgjonte me vëmendje dhe shënonte çdo gjë, për t'i çuar pastaj te partizanët e batalionit.

Dilnin mjafjt detyra dhe probleme që u duhen shin svaruar partizanëve, po puna politike me partizanët bëhej jo vetëm nëpër mbledhje, por edhe gjatë marshimeve.

Më 21 shkurt Batalioni i dytë radhitet pas Batalionit të parë në marshimin e madh që udhëhiqet nga komandanti i Brigadës shoku Mehmet Shehu. U nisën prej Zereci, në Moglicë, Strelcë, Velçan i Gorës, Niçë, Osmat. Bora kishte krijuar një shtresë të trashë dhe krejt të paçarë.

Më 26 shkurt në drekë në Çezmën e Vogël të gjithë partizanëve u foli vetë komandanti i Brigadës, shoku Mehmet Shehu:

«Shokë! Shtabi i Përgjithshëm na ka ngarkuar me një mision me shumë rëndësi. Kjo barrë i ngarkohet Brigadës I. Misioni ynë është aq me rëndësi saqë mjafton të kryhet edhe sikur dy batalione të asgjësohen për t'ia mbërritur objektivit. Përpresa nesh ndodhen pengesa gati të pakapërcyeshme, porse ne të Brigadës I mund t'i kapërcejjmë po të duam dhe do t'i kapërcejjmë. Do të udhëtojmë shumë larg, do të kapërcejjmë lumenj e male me dëborë, do të udhëtojmë për ditë e netë të tëra, pa bukë, pa gjumë, zbatohur e zhveshur, kështu siç jemi, do të ndodhemi në zona të rrrethuara nga ballistë dhe gjermanë. Kjo është gjendja përpresa nesh. Tashti secili prej jush të mendohet mirë para se të flasë dhe të gjithë ata që nuk e shohin veten në gjendje që të marrin pjesë në këtë udhëtim heroik të dalin më-njanë e të mbeten këtu në Mokër».¹⁾

1) «Shpresë për popullin, tmerr për armikun», 1977, f. 239.

Këto fjalë si të gjithë partizanët e emocionuan shumë Lymin, i dhanë më shumë guxim, forcë, besim.

Të gjithë jemi gati... Rroftë Shtabi i Përgjithshëm; është dhe zëri i Lymit që shkrihet me zërat e gjithë partizanëve dhe tingëllon fuqishëm.

Vazhdon udhëtimi, bie borë e përzier me shi. Gjithë vëmendjen komisari e kishte përqëndruar te kryerja e aksionit.

Pas çarjes së rrethimit në Skrockë, vazhduan udhëtimin edhe natën, sepse ndiqeshin nga forcat e armikut.

Kolona u nda në dy pjesë. Batalioni i dytë që ishte në krahun e majtë do të dilte në krye të lagjes së sipërme të Hotolishtit dhe që andej do të vazhdonte udhëtimin në drejtim të kasolleve të Dragostunjës. Duke udhëtar, pas pak, ai u fut në përroin e thellë të Kokrevës. Prej këtu nuk mund të vazhdonin më udhëtimin. Që ta kaloje këtë vend duhej të kacavirreshin nëpër shkëmbinj duke zgjedhur vendin, e duke u kapur pas shkurreve e barishteve, por errësira e natës nuk lejonte një gjë të tillë. Fshati ishte larg. Komandanti i batalionit dhe komisari (Lymi) vendosën që batalioni ta kalonte natën aty ku ishin. Bënte shumë ftohtë, 7 gradë nën zero. Natën nisi të bjerë borë, frynte erë. Zjarr s'mund të ndizej. Por zemrat e partizanëve ishin vetë zjarr, ato i mbante të ndezura fjala e Partisë. Lymi sa te njëra kompani te tjetra, bisedonte me partizanët, u jepte kurajë.

— Do të çajmë, ja sa të zbardhë që të shohim vendin nga mund të kalojmë.

Sapo drita nisi të zbulojë kurrizin prej shkëmbi të atij vendi batalioni çau përpara duke iu ngjitur

shkëmbinjve me vështirësi. Arritën në Hotolisht ku morën një udhërrëfyes pér në kasolle e Dragostunjës.

Në mbrëmje u takuan të tre batalionet në këto kasolle, në malin e Shebenikut mbi 1500 metra lartësi. Lymi interesohej pér strehimin e partizanëve nëpër këto kasolle. Ndezën zjarr dhe megjithëse kishin mbi dy ditë pa ngrënë, u kapitën dhe i zuri një gjumë i rëndë. Komanda e brigadës mori masa pér ushqimin e partizanëve duke blerë disa krerë bagëti.

Gjermanët e ballistët i ndjekin partizanët prandaj që në mesnatë jepet urdhéri pér t'u nisur në drejtim të Qarrishtës pér të dalë në Llëngë. Batalioni i dytë vihet në pararojë. Partizanët e këtij batalioni mbajtën në shpinë përveç armëve individuale dhe armët e rënda, gjë që ishte tepër e vështirë në ato kushte marshimi, pa ngrënë, pa gjumë, përmes borës së madhe. Vetëm një mitraloz peshonte 40 kilogram. Sa e vështirë ishte kjo, duheshin sakrifica të mëdha. Por të gjitha i mposhtte morali i lartë i partizanëve. Kolona çante malin. Po zbardhët mëngjesi. Dëbora e bardhë sikur e dyfishonte zbardhjen e dritis. Pishat e larta me krahët e gjatë të veshur me qyrkun e dëborës sikur zgjateshin t'i përshëndetnin trimat partizanë, që po kryenin një mision kaq të rëndësishëm.

Gjermanët, ballistët, i ndjekin, dëgjohet zhurma e tyre. Por partizanët nuk tremben aspak. Ecin, ecin. Para tyre del Qarrishta në një gropë mbi atë mal të lartë. Futen në Qarrishtë por atje janë ballistët. Nuk mund të çlodheshin, megjithëse ishin mjaft të lodhur. Komandanti i Brigadës e kishte vlerësuar drejt situatën, ai nuk pranoi mendimin e

kryeplakut që të qëndronin gjatë në Qarrishte.

Çdo partizan, pasi merr një copë bukë misri nisi përsëri, çajnë pritën e çetës së ballistëve, dhe përmes plumbave, nëpër shkallën e dhive¹⁾ shpejtojnë për të zënë qafën. Në këtë situatë të vështirë priu komandanti i Brigadës shoku Mehmet Shehu.

Të gjithë u hodhën në sulm drejt qafës, drejt tytave të pushkëve e mitralozëve të armikut. Lymi ishte në mes të partizanëve të batalionit, ai pasonte urdhrin e komandantit të Brigadës për të arritur objektivin. Megjithëse pa gjumë, pa ngrënë me një forcë të mahnitshme ngjiten malit përpjetë nëpër shkrepë, dushqe, çajnë rrethimin e armikut.

Por praparoja mbeti në Qarrishtë, ajo ndeshej me gjermanët. Krismat dëgjoheshin.

— Sa keq që s'u shkojmë dot në ndihmë, — i thotë Lymi komandantit të batalionit duke hedhur vështrimin andej nga vinin krismat. Djersët i rridhën nga balli e i ngrinin mbi mustaqet e holla.

Por përsëri në marshim. Misioni ishte shumë i rëndësishëm prandaj duhej shpejtuar. Gjermanët e ballistët përpinqeshin të mbyllnin rrethimin.

Ecnin natën nëpër déborën e trashë. Frynte furtunë.

— Përpara shokë!

Thirrjet i nxitin më shumë partizanët, i mobilizojnë, u japid forcë të mposhtin lodhjen dhe vështrësitë. Por jo vetëm thirrje por dhe ndihmë konkrete. Merr vetë në krah armatimin. Shpesh i vë vetë shpatullat mitralozit. Nga çanta e tij nxjerr një

1) Është një vend i ngushtë ku mund të kalojnë vetëm dhitë, nga njëra anë gjëndet një humnerë e thellë.

copë bukë, ia jep mitralierit. Eshtë lodhur më shumë — mendon.

Kalimi i Kaptinës së Martaneshit

Kalimi i Kaptinës së Martaneshit ishte një akt heroik i Brigadës I Sulmuese. Për mundësinë e kallimit u pyetën shumë fshatarë vendas.

— Eshtë e pamundur, — thoshin shumica. — Kaptina e Martaneshit nuk kalohet në kohë të mirë e jo në këtë borë kaq të madhe.

— Do të bëni gabim, se do të mbeteni të gjithë në borë, — u thoshte një fshatar nga Martaneshi.

Rrugë tjetër s'kishte. Komanda e brigadës e kishte studiuar mirë gjendjen: ose do të kalonin Kaptinën ose do të binin në pritat e forta të gjermanëve e të ballistëve.

Por edhe fjalët e fshatarëve vendës nuk ishin të kota, prandaj Lymi e ndiente përgjegjësinë që kishte ai dhe komunistët e tjerë për të kriuar te partizanët një atmosferë besimi.

Dhe besimi tek ata ishte i plotë. Partizanët e Brigadës I S ishin të kalitur ideologjikisht, politikisht, fizikisht; ishin të regjur me vështirësitë.

Gjatë gjithë rruget për të çarë nëpër Kaptinën e Martaneshit Lymi qëndroi i palodhur, printe me shembullin e tij, u jepte kurajë shokëve.

— Edhe pak e kaluam, s'ka majë që s'kapim ne, o burra, — ishin fjalët e zjarrta, që dilnin shpesh nga goja e tij.

Dhe kështu duke mposhtur vështirësitë futeshin në mes të shtëllungave të reve të bardha. Kaluan

nëpër pllajat plot lisa të gjatë ahu, që ngrinin koken e zbardhur nga bora si për të përshëndetur trimat. U varën poshtë në Martanesh duke prishur me guxim planin e armiqve për të rrethuar Brigadën.

Lymi me një shok atë natë qëndroi në një shtëpi ku ndodhej vetëm një plakë dhe tre djem. Ajo i priti me dashuri dy partizanët.

— Ku është i zoti i shtëpisë? — e pyetën.

— Këtu është, këtu, — u tha plaka, — po hyni brenda. Pastaj u ndezi një zjarr të madh.

— S'gjen asnjë burrë nëpër shtëpi, — vazhdoi ajo.

Lymi dyshoi dhe duke e pyetur me takt plakën, arriti të merrte vesh se djali i saj nuk ishte në shtëpi sepse e kishte mobilizuar xhandarmëria dhe «Balli Kombëtar» si shumë burra të tjerë të fshatit. Nga biseda me të ai e kuptoi se vërtet kishin hyrë nëpër shtëpi, por fshati ishte i rrethuar.

Megjithëse nën ngrohtësinë e zjarrit që bubullonte në oxhak Lymit po i mbylleshin sytë për gjumë, ai u ngrit. Sapo doli në rrugë mori urdhrin që batalioni në ora 12 të natës duhej të nisej përmarshim.

Në orën e caktuar batalioni merr rrugën përm nga Shkalla e Valit, i vetmi shteg nga mund të kalohej. Shpejt u dëgjuan krismat e pushkëve dhe të mitralozavë të armiqve të vendosur në prita përrpara dhe nga krahët.

Shtabi i batalionit vepronte me zgjuarësi e shpejtësi, për të çarë rrëthimin që të mos pengohej marshimi.

E vjetmja rrugë nga ku duhej të çuhej ishte kalimi i Shkallës së Valit me 72 dredha. Kalimi ishte

i vështirë. Përveç vështirësive të terrenit dhe të kohës partizanëve u duhej ta pastronin vendin nga armiqjtë që kishin zënë pozicionet. Kjo detyrë i ishte ngarkuar Batalionit të tretë, kurse Batalioni i dytë mbronte krahët e kolonës. Nga të dhënat u mor vesh se një grup reaksionarësh kishin zënë një pritë në një shteg në mes të dy shkëmbinjve, pritë e cila rrezikonte kolonën pas shpine. U ngarkua një skuadër me mitraloz për t'i marrë krahët dhe për ta asgjësuar. Lymi bashkë me një skuadër shkoi në afërsi të armikut.

— Prit, i tha mitralieri, i cili kishte vënë mitralozin në një vend të maskuar.

— Do të iki, — tha Lymi dhe u sul barkas. Por dy shokët e mbajtën.

Kishin qëndruar pranë dy shkëmbinjve kur u dëgjuat mitralozi partizan, i cili la të vdekur dy prej armiqve, ndërsa tjetri iku shkrepave.

Pas kryerjes me sukses të detyrës, Brigada I u përqëndrua në Popçisht ku u zhvillua konferenca e Brigadës.

Më 9 prill u zhvillua mbledhja e anëtarëve të Partisë të Brigadës. Ajo ishte njëkohësisht mbledhje dhe seminar teorik. Lymi dëgjonte me vëmendje dhe ngrihej nëpër këto forma ideologjikisht e politikisht. Gjatë gjithë kohës së marshimit në Veri mbledhjet e organizatës ishin bërë në rregull, këto nuk ishin lënë pasdore as gjatë rrugës; gjithashtu ishin zhvilluar në rregull edhe mbledhjet edukative për studimin e materialeve të Partisë.

Nga muaji prill-maj 1944 Lymi ishte pjesëmarrës në luftimet që zhvilloi Batalioni i dytë në Gorë dhe në Mokër kundër garnizonëve gjermane dhe forcave balliste; mori pjesë në çlirimin e Vërgës dhe të Shpatit.

Në aksionin për çlirimin e Pogradecit

Për çlirimin e Pogradecit, Batalioni i dytë kishte marrë detyrën të godiste forcat gjermane dhe të xhandarmërisë brenda në qytet. Reparti i xhandarmërisë përbënte batalionin «Luboten» prej 350 vëtësh, që ishte një nga repartet më të zgjedhura të qeverisë kuislinge.

Komanda e batalionit në të cilën merrte pjesë edhe Lymi përcaktoi objektivat e sulmit për çdo kompani. Njëra do të përqëndronte goditjet në hotelin buzë ligenit ku ndodheshin xhandarët. E dyta do të depërtonte në qytet nga perëndimi dhe do të godiste gjermanët në hotelin në mes të qytetit, kurse tjetra do të sulmonte armiqjtë në kala.

Lymi ndodhej me kompaninë e krahut të djathët e cila shkoi me shpejtësi dhe doli në breg të ligenit duke i bërë rrethim të hekurt armikut nga ana e lindjes. Luftimet vazhduan gjithë ditën. Xhandarët në kala u thyen keqas dhe u detyruan të mbyllen në hotel.

Komanda e batalionit vendosi që të pritej nata për të ndërmarrë veprime vendimtare.

Natën, duke gdhirë 18 prilli 1944, luftëtarët iu afrouan hotelit, qëlluan me bomba, por s'pati dobi. Atëherë vendosën t'i vënë flakën. Flaka e mbuloi hotelin, por gjermanët nuk donin të dorëzoheshin. Partizanët me mitraloza kishin mbyllur çdo hyrje e dalje të ndërtuesës. Lymi kishte marrë pjesë vetë në caktimin e çdo vendi për bllokimin e forcave me qëllim që gjermanët të mos gjenin asnjë shteg kallimi. Gjashtë armiq që bënë provë të dilnin ngelën të vrarë, tre të tjerë u kthyen prapa. Të gjithë u dogjën të gjallë.

— Si minj tē digjen, — thërriste Lymi dhe kur hoteli u shemb nga flaka ai sē bashku me forcat u drejtuan buzës sē liqenit ku ishin përqëndruar tradhtarët. Ishte vështirë t'i afroheshe e tē godisje hotelin me bomba e shishe me benzinë sepse vendi rreth e qark s'kishte ndërtesa. Iu bë thirrje tē dorëzoheshin, por ata nuk pranuan. Filloi një luftë e ashpër. Armiqtë qëllonin nga dritaret. Nën mbrojtjen e mitralozave tē Batalionit tē dytë që lëshonin zjarr tē dendur e tē përqëndruar, partizanët u afrojan me shpejtësi dhe hodhën bombat. Armiqtë u detyruan tē ngjiten në katin e dytë tē hotelit.

Lufta vazhdonte e ashpër. Në katin e parë u futën partizanët dhe nuk lejonin asnjë xhandar tē largohej. Ata duke u gjëndur në mes tē zjarrit nga tē gjitha anët, u dorëzuan.

Lymi shikonte me gëzim Pogradecin e çliruar pas 35 orë luftimesh tē rrepta dhe mendonte: Kështu do tē çlirohen dhe qytetet e tjera.

Mbledhja e anëtarëve tē Partisë tē brigadës që u bë më 3 maj 1944, ishte vazhdimi i asaj tē 9 prillit. Këto mbledhje e ndihmonin shumë. Horizonti i tij rritej vazhdimisht. Ai lexonte materialet që i jepe-shin dhe i kuptonte mirë problemet.

Nga kjo mbledhje Lymi u sqaruà akoma më te-për për detyrat e tij, për punën që duhej bërë. Ai nuk kënaqeji nga puna që bënte dhe luftonte me veten e tij, bluante mendimet sesi tē kryente sa më mirë detyrat, tē gjente gjuhën e gjithësecilit si tē partizanëve ashtu dhe tē masës së gjerë tē popullit, për tē depërtuar në zemrën e tyre, për tē çuar te ata vijën e Partisë.

Përsëri në Shpat

Në prill të vitit 1944 Lymi ndodhej me batalionin në Mokér. U dha urdhri që të kalonte në Shpat për të spastruar nga armiqtë rajonin e Polisit, të bllokonte Qafën e Thanës dhe rrugën Elbasan-Gramsh për të mos lejuar depërtimin e trupave gjermane e reakkionare drejt Mokrës e Vërçës. Si në çdo batalion dhe në batalionin e dytë u formua kompania e katërt. Radhët e batalionit ishin shtuar në saje të punës së madhe që kishin bërë komunistët. Batalioni tanë përbëhej prej rreth 300 vetësh.

Një kujdes tregonte Lymi për veshmbathjen e partizanëve të rinj. Një pjesë prej tyre ishin të zbatur e të zhveshur. U bënë disa opinga me lëkurët e buajve dhe të qeve të bejlerëve të Starovës.

Më 6 maj Batalioni i dytë ndodhet i përqëndruar në Bërzheshtë. Në mbrëmje i vjen urdhri nga shtabi i Brigadës për një aksion në fshatin Skroskë. Ndërsa Batalioni i parë sulmonte gjermanët në Shtërmen, Gostimë e Shtepaj, batalioni i dytë do të spastronte fshatin e Skroskës nga forcat gjermane e balliste.

Të nesërmen Lymi me një kompani të Batalionit të dytë bashkë me një kompani të batalionit «Reshit Çollaku» sulmuan një bandë reakkionarësh prej 200-250 vetësh në Kotodesh afér Qafës së Thanës. Në këto luftime u plagos rëndë Neshat Saliu, mitralieri i kompanisë, i cili vdiq pas gjysëm ore. Mitralozin e mori shoku i tij. Forcat balliste po afroheshin, tërheqja e trupit të tij ishte e pamundur.

Atëherë Lymi si njeri i iniciativës, vendosi aty për aty që shokun e vrarë ta varrosnin. Me shpejtësi, bashkë me dy partizanë hapën aty ku ishin një gropë me bajonetë e me duar dhe e varrosën

shokun e tyre me dhimbje të madhe. E varrosën që të mos binte në duart e armikut e përshndetën me një breshëri dhe vazduan betejën.

Batalioni i dytë mori pjesë në pastrimin e Polisit, që armiqtë e mbanin si një bazë të rëndësishme dhe e quanin kështjellë të pathyeshme. Shkatërrimi i kësaj baze hapte shtegun përmësymjen e brigadës përtej Shkumbinit.¹ Pas Polisit batalioni sulmoi Vilanin për të pasur këtë shteg të hapur përgoditjet vdekjeprurëse që do t'u jepnin gjermanëve në sulmet e kundërsulmet. Ai mori pjesë në përlleshjet e përgjakshme në Gramsh e Skrapar, Opar e Tòmoricë, në Tomor e Sulovë, Kërpicë e Shëmbërdhenj.

Këtu Lymi tregoi dhe një herë shpirtin luftarak prej revolucionari të klasës punëtore, të komunistit që skurseu as jetën e tij për çështjen e atdheut dhe të popullit, ngriti figurën e komisarit politik që di t'i kthejë fjalët në vepra.¹⁾

Për Lymin nuk kishte program dhe kufij përtë punuar me partizanët dhe popullin. Ai e bënte atë vazhdimisht, ditën dhe natën, nëpërmjet mbledhjeve dhe jashtë tyre, në pushimet dhe gjatë luftimeve. Lymin e gjeje të fliste me partizanët, gjatë orëve të çlodhjes, në pozicione duke luftuar, gjatë marshimeve, kudo.

Lymit nuk i pëlqenin privilegjet që mund t'i bëheshin nga të tjerët, ngaqë edhe vetë nuk bënte dallime në sjellje, veshje apo çfarëdo lloj trajtimi tjetër. Sa herë që ndahej ushqimi Lymi do të rrinte në këmbë, duke u kujdesur për shokët dhe vetë do

1) F. Radovică. «Revolucionari i palodhur» Gazeta «Bashkimi» 8 korrik 1974

të merrte kurdoherë i fundit. Në baza për të pushuar do të shkonte i fundit pasi të ishin sistemuar të tjerët¹⁾

Kalimi i Shkumbinit

Brigada I, në përbërje të Divisionit I Sulmues, mori urdhrin për të kaluar në Veri. Do të kalonin Shkumbinin, do të hidheshin në Çermenikë dhe pastaj në Veri.

Para nisjes organizata e Partisë kishte bërë një punë të mirë sqaruese me batalionin. Sqarimi i situatës kishte mjaft rëndësi.

Sipas detyrave që kishte caktuar komanda e brigadës, Batalioni i dytë u nis. Morali i partizanëve ishte shumë i lartë, ata ishin plot optimizëm dhe besim. Kaluan në drejtim të Fushbuallit në Labinot-Fushë, në Mal-Qerret.

Kalimi i Shkumbinit paraqiste vështirësi, ai ishte një aksion i rëndësishëm. Në xhade ishin postat gjermane të përforcuara me xhandarë, të mbrojtura nga fortifikata. Në to kishte lëvizje të mëdha autokolona të armikut. Vendi ku do të kalohej ishte 7 km afér Elbasanit.

Lymi bashkë me komandantin e batalionit e komendantët e kompanive udhëzojnë partizanët për të lëvizur në fshehtësi të madhe dhe vetëm natën.

Ditën e 28 qershorit qëndruan në pyll në maskim të plotë. Vetëm një disiplinë e hekurt, një ven-

1) F. Radovicka. «Revolucionar i palodhur», Gazeta «Bashkimi» 8 korrik 1974.

dosmëri e ndërgjegje e lartë mund të përballon te vështirësi të tillë.

Komanda e brigadës kishte dërguar grupin e zbulimit. Në orën 20.30' u dha urdhër për të kaluar Shkumbinin. Ishte natë e errët. Shkumbini kishte shumë ujë dhe ishte mjaft i ftohtë.

Batalioni do të kalonte grupe-grupe që të mos diktohej. Ai duhej të kalonte pranë urës së Labinotit të Poshtëm. Sinjali i kalimit jepej me fener të ndezur. Kalimi u bë me sukses. Mëngjesi i 29 qershoret i gjeti në Dragostunjë dhe në Labinot-Mal. Atë ditë bënë spastrimin e zonës nga ballistët e tradhtarët.

Populli i priti me dashuri të madhe, gjëzoheshin pleq e fëmijë, burra e gra.

Partizanët u ftuan nga fshatarët për të kaluar me ta natën. Lymi me dy partizanë ishin mysafirë te një familje e varfër. Por ajo i priti plot bujari e me sofër plot. Ai u prek nga pritja e fshatarit dhe e qortoi që ishte shpenzuar. Për ta mjaftonte pak bukë me gjizë.

— Për ne është festë sot që na çliruat nga ballistët e tradhtarët, — i tha fshatari.

Biseda me të zotin e shtëpisë dhe fëmijët e tij që mjaft interesante.

Lymi i sqaronte me pjekuri situatën dhe fliste me optimizëm për të ardhmen. Fshatarit i ndrisnin sytë nga gjëzimi.

Biseda vazhdoi gjer vonë rrëth zjarrit. E zonja e shtëpisë lau rrobet e Lymit dhe të dy partizanëve të tjerë dhe i vuri pranë zjarrit të thaheshin. Fëmijët qëndruan deri vonë, gjumi nuk i zinte. Njëri nga djemtë e fshatarit, që s'ishte më shumë se dhjetë

vjeç, kishte vënë në kokë kapelen e Lymit dhe përshëndeste si partizan.

Nga mesi i natës komisari dhe dy partizanët dolën. Dy kompanitë do të zinin pritën në rrugën Elbasan-Libratzhd, në lindje të Mirakës, nga ku pritej të vinte një autokolonë gjermane.

— Mos bre shoku komisar, pse kaq shpejt, por ne s'u çmallëm bashkë, — u tha fshatari duke u vënë në çantë bukë e qershi.

— Jo këto janë të tepërtë, — tha Lymi. — Qershë hengrëm mjaft. Bukën po e marrim.

Mbasi u përqafuan me mall më fshatarin partizanët u larguan, por ata mbetën të gjallë në sytë dhe mendjen e tij, sidomos komisari.

Aksioni i fundit

Ishin ditët e para të korrikut. Lymi u fliste me zjarr shokëve për sukseset që kishin arritur forcat e Divisionit I Sulmues duke cliruar mjaft zona të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Në sytë e tij shkrepëtinte optimizmi, besimi për fitoren.

— Së shpejti do t'i vijë radha dhe Tiranës, — u thoshte Lymi shokëve të tij, gjatë rrugës për në Dibër.

Kishte dëshirë të madhe të futej në strofkën e armikut në këtë qytet dhe të merrte pjesë në clirim e tij, të shihte qytetin e tij të lirë, njerëzit, vëllezërit motrat e tij të qeshur e të gëzuar.

Gjatë kohës së qëndrimit në Zerqan, marrin vesh se u clirua Shupenza, Homeshi e Peshkopja. Por në Peshkopi ishin krijuar disa rrethana të vështira nga mercenarët e Halil Alisë dhe forcat e xhandarmërisë.

Një urdhër i rrëndësishëm vjen nga Shtabi i Divizionit I Sulmues dhe i Brigadës I Sulmuese. Batalioni i dytë ngarkohej më detyrë që të depërtonte drejt Veriut për t'u bashkuar me forcat e Batalionit të Dibrës për spastrimin e zonës së Peshkopisë nga mercenarët e Halil Alisë. Këtë urdhër Komunistët e quan gjér në zemër të çdo partizani, të cilët si gjithnjë ishin të gatshëm për aksione dhe e quanin për ndër kur u ngarkohej ndonjë mision i tillë.

Batalioni i dytë niset në mbrëmjen e 7 korrikut nga Zerqani dhe arrin në Peshkopëtë e mbrëmjen e 8 korrikut, pas një rruge të gjatë duke çarë midis forcave reaksionare që kishin zënë vend në krahun e Dibrës së Madhe dhe fushës së Maqellârës. Një pritje e përzemërt u bëhet nga populli i Peshkopisë dhe forcat e Batalionit të Dibrës e të Batalionit të Lumës.

Ishin mjaft të lodhur nga rruga. Partizanët u ulën të pushonin, ndërsa shtabet e zonës së Dibrës dhe i Batalionit II u mblodhën për të vlerësuar situatën. Me nxitjen e shtabit të Batalionit të Dibrës që nuk e paraqiti drjet gjendjen e forcave të reaksionit, në këtë zonë u vendos që t'u jepej një goditje e befasim me forcave reaksionare që atë natë. Goditja të bëhej në Fushë-Aliaj, në strofkën e Halil Alisë. Sipas planit partizanët do të marshonin natën që në mëngjesin e 8 korrikut të rrethonin Fushë-Aliajn.

Megjithëse nuk kishin bërë më shumë se dy orë pushim, atë mbrëmje korriku morën rrugën për në Shumbat që ndodhej në Verilindje të Fushë-Aliajt.

Nata ishte e errët. Por partizanët gjithë zjarr në gjithë ploturrejtje në zemër ecin, mpôshtin lodh-

jen, gjumin që u rendon. Katër orë marshim dhe ja, arritën në vendin e caktuar.

Kishte kaluar mesi i natës, hëna dilte herë pas here nga retë e holla për t'u zbuluar vendin, fortifikatat, llogoret që kishin përgatitur armiqjtë për mbrojtjen e kësaj qendre të reaksionit. Lymi bën pjesë në forcat e batalionit që sulmon në pjesën e sipërme të fshatit. Forcat e tjera sulmonin në anë të ndryshme për ta futur në darë të hekurt armikun. Mercenarët nuk kishin qëndruar pasivë që të kapeshin në befasi. Kishin lënë forca nëpër këto llogore në kodër. I thyejnë këto forcë, të cilat detyrohen të tërhiqen në fshat. Vazhdon marshimi në formacion luftimi drejt fshatit. Pastaj luftimi u shtri shtëpi më shtëpi.

Partizanët suleshin si vetëtima duke i kallur tmerr armikut. Me gjithë sulmin e rrufeshëm të partizanëve, po kalonte mesdita dhe lufta vazhdonte e rreptë sepse armiqjtë kishin si mburoja shtëpitë. Krismat e pushkëve e të mitralozëve të partizanëve dëgjoheshin deri larg, shtëpitë, kodrat, përhapnin jehonën e tyre. Dara e rrethimit të qendrës së reaksionit vinte duke u shtrënguar shumë. Dielli ishte shumë i nxehthë, djersët si rrëke rridhnin nëpër trupin e partizanëve. Sa e dëshiruar ishte dhe një pikë uji në këtë ditë të nxehthë. Por partizanët s'duan të dinë, vazhdojnë betejën.

Oshëtima e luftës në Fushë-Aliaj dëgjohej deri larg, kjo bëri të tërbohet paria vendëse, xhandarët dhe instruktorët gjermanë që ndodheshin përtej Drinit. Ata shtuan forcat dhe me shpejtësi sulen për t'u ardhur në ndihmë mercenarëve të Halil Alisë në krah të majtë dhe t'u binin prapa partizanëve andej nga nuk pritej. U krijuar një situatë e vështirë. Forca

të mëdha mercenarësh kalonin Drinin dhe tentonin për t'u bashkuar me mercenarët brenda në fshat. Komisari trim që ndodhej në këtë krah kur pa forcat e shumta që mundoheshin të rrëthonin batalionin me tërbim, mori masa bashkë me shokët e tjerë për të mbrojtur batalionin nga rrëthimi.

I vetmi mitraloz që dispononin u vu në veprim dhe vilitë zjarr ndaj armiqve. Situata kërkonte një ndeshje të rreptë, një sakrififikim për çështjen e përgjithshme.

— Në sulm! Si gjithnjë i pari në sulm është komisari trim, janë shokët partizanë që godasin me zjarr armikun.

Lymi vazhdon të qëllojë pa pushim, pa e humbur gjakftohtesinë, besimin për fitore. Forcat mercenare që janë brenda në fshat nëpër shtëpi marrin zemër nga ndihma që po u vinte dhe vazhdojnë të qëllojnë pas shpine partizanët nga frëngjité e disa shtëpive. Partizanët ndodheshin në mes dy zjarresh. Armiqtë filluan të shfrytëzojnë terrenin për t'iu afruar pozicioneve të partizanëve. Duhet prerë rruga! Lymi përpinqet të vëré sa më shumë në shënjetër, por papritur ra. Një plumb për vdekje e goditi në gjoks. Ishin mercenarët që qëllonin nga fren gjitë e shtëpive. Pushkën e tij e rrëmbyen shokët trima që u ndodhën pranë. Forcat partizane të rior ganizuara, me sulm çanin për t'i prerë rrugën armikut, lëvizin, ndërrojnë pozicionet. Vrasja e komisarit rrit ndjenjën e hakmarrjes, rrit guximin, hidhen, qëllojnë pa pyetur për vdekjen.

Partizanët me heroizmin e guximin e tyre bëjnë që armiku të pësojë disfatë. Dëmet e tij ishin të pallogaritshme. Por në këtë luftë partizanët e batalionit humbën komisarin e tyre trim me të cilin ki-

shin ndarë hallet e brengat. E shikonin me dhimbje të thellë. Në gojë sikur i kishte mbetur fjala — Përpara! Sytë sikur vrojtonin përsëri me rreptësi ndaj armikut. Dielli sikur ishte ulur mbi ballin e tij. Fusha kishte shtruar qilimin e blertë të ngrohtë të spërkatur me gjak.

Ndahen partizanët për herë të fundit nga komisari. Ai mbetet në kujtesën e gjithsecilit si njeri i aksionit, i vijës së parë të betejës, si luftëtar, si udhëheqës, me cilësitë më të larta që e karakterizojnë komunistin.

— Do t'ia marrim hakun Lymit, do t'ua marrim hakun të gjithë bijve që ranë sot, u betuan partizanët.

Ra Lymi, por dëshirën, ëndrrat e tij i bënë realitet partizanët, shokët e tij që vazhduan luftën, çliruan zona të tëra të Shqipërisë së Veriut. Batalioni ku militoi ai, mori pjesë së bashku me formacionet e tjera të Ushtrisë Nacional Çlirimtare në çlirimin e Tiranës, plotësoi dëshirën e tij, i bëri me diell ato rrugica të errëta të varfëra të qytetit të tij të lindjes, e bëri dhe Tiranën të marrë frymë e lirë.

Kalojnë vitet. Rrugët e Tiranës si në të gjithë vendin, zhurmojnë nga zhurma e autobuzëve që gjonë punëtorët në punë, zhurmojnë nga zërat e fëmijëve që shkojnë të gëzuar në shkollë, nga zërat e njerëzve që të lumtur ndërtojnë Shqipërinë e lirë socialiste.

Këto janë ëndrrat e realizuara të Lymit e të mijëra e mijëra të tjerëve që ranë në fushën e nderit.

Ndaj populli me të drejtë këndon për Myslym Shyrin:

*Në dyzet e katrën,
në luftë për liri,
secⁱ derdhe gjakun,
ti për Shqipëri.*

*Shqipëria u bë,
siç e deshe ti,
me Partinë, Enverin,
para shkon gjithnjë.*

* * *

Populli, Partia i ngre në piedestalin e nderit e të lavdisë heronj të tillë.

Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekret Nr. 4600, datë 22.11.1969 i jep Myslym Shyrit (pas vdekjes) titullin «Heroi i Popullit» me këtë motivacion:

«Në përgjigje të thirrjes së Partisë, që në ditët e para të formimit të saj, u bë një luftëtar i shquar i njësiteve guerile dhe i reparteve partizane më vonë, që me devotshmëri të lartë plotësoi të gjitha detyrat që iu ngarkuan, u shqua si udhëheqës i formacioneve partizane dhe në përleshje me armiqtë tregoi aftësi dhe trimëri të rrallë derisa për kauzën e madhe të Partisë e të popullit dha jetën në ballë të luftës».

P E R M B A J T J A

Faqe

Fëmijëria	3
Fillimi i aktivitetit revolucionar	12
Rruga e re	29
Në Çetën e Pezës	40
Në Çetën e Dumresë	45
Në Brigadën I Sulmuese	53